

RAPORT
I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS
PËR THERRTOREN “FRESKIA” VOKSH-DEÇAN

Maj 2026
Prishtinë

Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis
për
Therrtoren për therjen e kafshëve të trasha

Aplikuesi	Haxhi Nitaj, pronar Thertorja Freskia Sh.P.K Decan, Kosovë Tel:+383 44 371 293	
Të dhëna për projektin	Titulli: Raport i vlerësimit të ndikimit në mjedis për projektin: Thertorja Freskia” Sh.P.K Vendndodhja e projektit: Decan	
Të dhëna për hartuesin e raportit	Lumnije Gashi Shabani Rr.Mitrush Kuteli 46, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +383 49 647 457 Lumnijegashi8@gmail.com Nr. i licencës 45/19	 The image shows a license document for Lumnije GASHI -SHABANI, an architect and diploma holder. The license is issued by the Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure of the Republic of Kosovo. It is valid for the preparation of environmental impact assessment reports. The license number is 45/19/24. The document includes the official seal and signature of the Minister of Environment, Spatial Planning and Infrastructure.
	Aida Dobruna Rr.Mustafa Hoxha 22, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës Tel: +383 49 112038 aidadobruna@gmail.com Nr. i licencës 30/19/24	 The image shows a license document for Aida DOBRUNA, an architect and diploma holder. The license is issued by the Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure of the Republic of Kosovo. It is valid for the preparation of environmental impact assessment reports. The license number is 30/19/24. The document includes the official seal and signature of the Minister of Environment, Spatial Planning and Infrastructure.
Data	Maj 2026, Prishtinë	

PËRMBAJTJA

1. HYRJE.....	5
1.1. Prapavija	5
1.2. Baza ligjore për hartimin e raportit	5
1.3. Metodologjia.....	7
2. PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I THERTORËS PËR THERJEN E GJEDHEVE TË TRASHA.....	8
2.1. Kategoria e projektit të propozuar	8
2.2. Përshkrim i punëve përgatitore për zbatimin e projektit	8
2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të Thertores dhe aktiviteteve të saj.....	8
2.4. Përshkrim detal i procesit të planifikimit të prodhimit.....	10
2.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme	11
2.6. Vlerësimin e gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik dhe prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave.....	11
2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit, asgjësimit të mbeturinave	
2.8. Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e funksionimit dhe përfundimit dhe rehabilitimit pas mbarimit të funksionimit të projektit	11
2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme	12
2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave	12
2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin.....	12
2.12. Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese	
3. PËRSHKRIM I LOKACIONIT TË THERRTORES	12
3.1. Lokacioni dhe ngastrat kadastrale, pronesi, skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit	12
3.3. Distanca me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti	14
3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit	14
3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë	14
3.6. Paraqitja e kërkesave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik	14
3.7. Prezantimi i karakteristikave natyrore	15
3.8. Rishikimi i karakteristikave themelore të peizazhit	15
3.9. Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike	15
3.10. Të dhëna për popullsisën përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar	15
3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese	15
3.12. Të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme	15
3.13. Të dhëna për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të tij	15
4. PËRSHKRIMI I ASPEKTEVE MJEDISORE PËRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE.....	15
4.1. Gjeologjia, toka dhe shfrytëzimi i tokës	15
4.2. Ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe menaxhimi i ujërave të ndotura	18
4.3. Ajri dhe rreziqet nga ndryshimet klimatike	20
4.4. Zhurma.....	20
4.5. Menaxhimi i mbeturinave	20
4.6. Ekologjia dhe biodiversiteti	21

4.7. Vendbanimi, popullata dhe çështjet socio-ekonomike	21
4.8. Peizazhi dhe ndikimi vizual	22
5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME	22
4.1. Skenari "Pa Leje mjedisore"	22
5.2. Skenari "Thertore që plotëson kushtet mjedisore"	23
6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË THERRTORES NË MJEDIS	23
6.1. Përshkrimi i metodave apo dëshmime të parashikimit	23
6.2. Përshkrimi i faktorëve që ka gjasa të ndikohen nga projekti	23
6.3. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis dhe i masave të parapara	24
6.3.1. Ndikimi në tokë dhe shfrytëzim të tokës	24
6.3.2. Ndikimi në ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe menaxhimi i ujërave të ndotura	24
6.3.3. Ndikimi në ajër dhe nga rreziqet e ndryshimeve klimatike	25
6.3.4. Ndikimi nga zhurma	26
6.3.5. Ndikimi në biodiversitet (florë dhe faunë) dhe ekosistem	26
6.3.6. Ndikimi nga mbeturinat	26
6.3.7. Vendbanimi, popullata dhe çështjet socio-ekonomike	27
6.3.8. Peizazhi dhe ndikimi vizual	28
6.3.9. Përshkrimi i cënueshmërisë së objektit të thertores ndaj aksidenteve dhe/ose katastrofave që ndërlidhen me funksionimin e tij	29
7. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS DHE PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR	29
7.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis	29
8. KONKLuzionet dhe Rekomandimet	31
9. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE	34
10. LITERATURA	34

Shkurtesat

UA	Udhëzimi administrativ	MMPH	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor
AMMK	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës	RKS	Republika e Kosovës
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis	KRU	Kompania Rajonale e ujësjellësit
QRK	Qeveria e Republikës të Kosovës	PZhK	Plani Zhvillimor Komunal
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës	PMM	Plani për Menaxhimin e Mbeturinave

1. HYRJE

1.1. Prapavija

Ky raport përbën një dokument të rëndësishëm në kuadër të funksionimit të thertores për therjen e kafshëve të trasha dhe të imta, duke synuar përputhjen me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së mjedisit.

Kompania e z. Haxhi Nitaj, me emrin tregtar “Mishtore Freskia” e cila përfshin edhe Therrtoren në Voksh të Deçanit, paraqet këtë Raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) si kërkesë e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH), me qëllim pajisjen me pëlqim mjedisor dhe më pas me leje mjedisore, pasi gjatë një inspektimi në terren është konstatuar se objekti, i ndërtuar në vitin 2002, nuk posedon një leje të tillë.

Qëllimi i këtij raporti është identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të mundshme në mjedisin përreth, përfshirë ndotjen e mundshme të ujit, tokës, ajrit dhe ndikimin në botën e gjallë, si dhe propozimi i masave për eliminimin ose minimizimin e këtyre ndikimeve në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore.

Raporti është hartuar mbi bazën e të dhënave të gjendjes ekzistuese të mjedisit dhe informacioneve të siguruar nga pronari i këtij biznesi dhe komunës përkatëse. Gjatë përgatitjes së tij janë kryer vizita në terren, matje me GPS dhe dokumentim fotografik, në funksion të një vlerësimi sa më të saktë dhe gjithëpërfshirës.

1.2. Baza ligjore për hartimin e raportit

Përgatitja e Raportit të VNM-së mbështetet në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili ka për qëllim të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit përmes parandalimit të dëmeve dhe efekteve negative në mjedis. Në hartimin e raportit janë konsultuar edhe ligjet tjera që mbulojnë fushat për: Mbrojtjen e mjedisit, Ujërat, Mbeturinat, Mbrojtjen e natyrës, Mbrojtjen nga zhurma, Cilësinë e ajrit, Parandalimin e Integruar dhe kontrollin e ndotjes (PIKN) dhe Trashëgimia Kulturore, etj si dhe aktet nënligjore relevante të prezantuara në tabelën vijuese.

Tabela 1. Ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse mjedisore dhe qëllimet dhe fushëveprimi i tyre

Ligji	Qëllimi
Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit (ndryshuar nga Ligjet Nr. 08/L-276 dhe 08/L-283, 2024)	Ligji rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtij ligji është të promovojë krijimin e mjedisit të shëndetshëm për popullin e Kosovës me sjelljen graduale të standardeve për mjedis të Bashkimit Evropian. Ndryshimet e vitit 2024 integrojnë parimet e Marrëveshjes së Gjelbër të BE-së, duke detyruar adaptimin ndaj ndryshimeve klimatike, promovimin e ekonomisë cirkulare dhe përmirësimin e monitorimit mjedisor dhe mekanizmave të përgjegjësisë. Ai siguron kuadrin e përgjithshëm për menaxhimin mjedisor sektorial dhe harmonizon detyrimet e Kosovës me konventat ndërkombëtare si Konventa e Aarhusit dhe Marrëveshja e Parisit.
Ligji No. 08/L-145 për parandalimin e integruar të kontrollit të ndotjes	Qëllimi i këtij ligji është parandalimi i ndërhyrjeve dhe kontrolli i ndotjes që buron nga aktivitetet industriale, veçanërisht duke parandaluar ose reduktuar mbeturinat dhe emetimet në ajër, ujë dhe tokë. Së bashku me instrumente zbatimi si Libri i Kuq i Florës (2013) dhe Libri i Kuq i Faunës (2019), ky ligj siguron bazën për ruajtjen e biodiversitetit në Kosovë, në përputhje me kategoritë e IUCN dhe konventat ndërkombëtare. Ligji operacionalizon obligimet nën Konventën e Bernës (1979), Konventën e Bonit (1979) dhe Konventën e Ramsarit (1971), duke siguruar harmonizim me Kërkesën e Performancës 6 të BERZH-it dhe Standardin Mjedisor dhe Social 6 të Bankës Botërore mbi ruajtjen e biodiversitetit dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore të gjalla.
Ligji Nr. 08/L-025 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Qëllimi i këtij ligji është të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit

Ligji Nr. 02/L-102 për Mbrojtjen nga Zhurma	Qëllimi i këtij ligji është të shmangë, parandalojë ose zvogëlojë në bazë të prioriteteve efektet e dëmshme, përfshirë edhe bezdisjen, për shkak të ekspozimit ndaj zhurmës. Ky ligj do të sigurojë bazën për zhvillimin e masave për reduktimin e zhurmës së emetuar nga burimet kryesore, veçanërisht nga trafiku ajror, rrugor dhe hekurudhor, pajisjet e jashtme dhe industriale, makineritë e lëvizshme dhe për burime të tjera të ndotjes akustike dhe bezdisjes së mjedisit.
Ligji Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës	Ky ligj rregullon çështjet që kanë të bëjnë me: ujërat sipërfaqësore, liqenet, depozitat, rezervuarët, burimet natyrore, ujërat nëntokësore, tokat e lagështa, tokat afër brigjeve të lumenjve, çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin, përdorimin dhe shpërndarjen e tyre të ujit, mbrojtjen dhe ruajtjen e ujit, mbrojtjen nga veprimet e dëmshme të ujit, duke përfshirë zhytjen, përmbytjet, thatësit, erozionin; objektet dhe infrastruktura ujore, financimi i ujit si dhe kushtet, metodat dhe aktivitetet me të cilat mund të shfrytëzohen apo lirohen ujërat.
Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Mbeturina Nr. 04/L-060 U.A. nr. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme	Ky ligj përcakton masat për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut duke parandaluar ose reduktuar gjenerimin e mbeturinave, ndikimet negative të gjenerimit dhe menaxhimit të mbeturinave duke reduktuar ndikimet e përgjithshme të burimeve, përdorimin dhe përmirësimin e efikasitetit të një përdorimi të tillë, të cilat janë thelbësore për kalimin në një ekonomi qarkore dhe për garantimin e konkurrencës. U.A. ka për qëllim përcaktimin e rregullave të grumbullimit, ndarjes në lloje, magazinimit, transportimit, trajtimit, deponimit dhe paketimit të mbeturinave të rrezikshme; përcaktimin e kushteve që duhet t'i plotësojnë objektet për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve lidhur me magazinimin, përpunimin, trajtimin, transportimin, paketimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme; ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e punëtorëve që menaxhojnë me mbeturinat e rrezikshme; parandalimin e përdorimit të substancave të rrezikshme dhe krijimit të mbeturinave të rrezikshme.
Ligji Nr. 02/L-26 për tokën bujqësore Udhëzimi Administrativ nr. 41/2006 për ndryshimin e përdorimit të tokës bujqësore	Ligji përcakton përdorimin, mbrojtjen, rregullimin dhe dhënien me qira të tokës bujqësore me qëllim të ruajtjes dhe mbrojtjes së përhershme të potencialit bujqësor, bazuar në parimet për një zhvillim të qëndrueshëm. Udhëzimi administrativ synon të vendosë procedurën administrative dhe kriteret e vendimmarrjes për ndryshimin e përhershëm ose të përkohshëm të shfrytëzimit të tokës bujqësore. Procedura kërkon një bashkëpunim të ngushtë të personave përkatës autoritetet kompetente për planifikim hapësinor dhe bujqësi.
Ligji Nr. 03/L-233 për Mbrojtjen e Natyrës	Ky ligj përcakton një sistem për mbrojtjen dhe ruajtjen e përgjithshme të natyrës (të gjithë diversitetin biologjik dhe ambienta) dhe vlerat e tij.
Ligji Nr. 04/L-120 për mbrojtjen e bimëve	Ky ligj parashikon kushtet për: a) mbrojtjen e bimëve dhe produkteve bimore nga organizmat e dëmshëm; b) parandalimin e hyrjes dhe përhapjes së organizmave të dëmshëm dhe çrrënjësjes së tyre; c) identifikimin e organizmave të dëmshëm; d) prodhimin dhe transferimin optimal të bimëve dhe produkteve bimore; f) zbatimin e mbikëqyrjes së përhershme të organizmave të dëmshëm, të vlerësimit dhe menaxhimit të rrezikut të tyre, të masave për mbrojtjen e bimëve dhe kryerjen e detyrave dhe raporteve të tjera; g) orientimin dhe monitorimin e zhvillimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e bimëve; h) mbledhjen, mirëmbajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacionit;
Ligji nr. 02/L-88 për Trashëgiminë Kulturore	Qëllimi i këtij ligji është rregullimi ligjor i fushës trashëgimisë kulturore në lidhje me ruajtjen, mbrojtjen, qasjen publike, komunikimin dhe pajisjen e burimeve të domosdoshme me qëllim që trashëgimia të shijohet nga gjeneratat e tashme dhe të jetë e gatshme për gjeneratat e ardhshme si një dokument historik dhe kulturor.
Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor	Ligji synon të sigurojë një zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar të planifikimit hapësinor në të gjithë territorin e Kosovës si vlerë e përbashkët kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit racional të hapësirës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore. Ai synon gjithashtu qeverisjen e qëndrueshme, përdorimin efikas të fondeve publike, parakushtet për zhvillim të balancuar ekonomik, rregullimin e qëndrueshëm të hapësirës, sigurimin e trajtimit të barabartë, ofrimin e lëvizjes së lirë dhe qasjen e duhur në shërbimet publike për qytetarët.
Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim	Ky ligj përcakton dispozitat që rregullojnë dhënien e lejes së ndërtimit, respektimin e kërkesave për leje ndërtimi dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit. Ky ligj rregullon ndërtimin e të gjitha objekteve ndërtimore në Kosovë, projektimin, ndërtimin, rindërtimin, rrënimin, nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë.
Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Nr. 04/L-161	Ky ligj parashikon sigurimin e kushteve në mjediset e punës me qëllim të parandalimit të lëndimeve në punë, masat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe mbrojtjes në mjedisin e

	punës. Mjedisi i punës konsiderohet çdo mjedis ku kryhet puna. Ligji mandaton Qeverinë e Kosovës që të formojë një Këshill për sigurinë në punë dhe mbrojtjen e mirëqenies së punëtorëve dhe mjediseve të punës.
Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore Nr. 04/-L-027	Ky Ligj ka për qëllim mbrojtjen dhe shpëtimin e njerëzve, kafshëve, pronave, trashëgimisë kulturore dhe mjedisit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera
Ligji nr. 08/L-261 për mbrojtje nga zjarri	Ligji rregullon organizimin, funksionimin, si dhe përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e sistemit dhe mekanizmeve të mbrojtjes nga zjarri, duke përfshirë edhe shpërthimet me qëllim të mbrojtjes së jetës së njerëzve, kafshëve, pasurisë dhe mjedisit.
UDHËZIMET ADMINISTRATIVE	
Udhëzim Administrativ	Qëllimi i udhëzimit
U.A. Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore	Udhëzimi ka për qëllim parandalimin dhe kontrollin e ndotjes nga aktivitetet industriale, poashtu përcaktimin e procedurës së aplikimit, shqyrtimit dhe procesit të vendim-marrjes për leje mjedisore
U.A. nr. 01/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e U.A.-së nr. 04/2022 për Leje Mjedisore	Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzimit Administrativ MMPHI – Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore në disa nene të tij dhe plotësimin e shtojcës 2 të UA-së
U.A. nr. 02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor	Qëllimi i këtij U.A. është rregullimi i procesit të grumbullimit, trajtimit dhe shkarkimit të ujërave të ndotura industriale si dhe përcaktimi i vlerave kufizuese të substancave ndotëse të ujërave të kanalizimit dhe përcaktimi i metodologjisë, shpeshësisë së mostrimit dhe analizimit të përbërjes së ujërave të ndotura para shkarkimit të tyre në sistemin e kanalizimit publik dhe në mjedisin pritës.
U.A. nr. 03/2021 për menaxhimin mbeturinave të rrezikshme	U.A. ka për qëllim përcaktimin e rregullave të grumbullimit, ndarjes në lloje, magazinimit, transportimit, trajtimit, deponimit dhe paketimit të mbeturinave të rrezikshme; përcaktimin e kushteve që duhet t'i plotësojnë objektet për menaxhimin e mbeturinave të rrezikshme, mbikëqyrjen dhe kontrollin e aktiviteteve lidhur me magazinimin, përpunimin, trajtimin, transportimin, paketimin dhe deponimin e mbeturinave të rrezikshme; ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e punëtorëve që menaxhojnë me mbeturinat e rrezikshme; parandalimin e përdorimit të substancave të rrezikshme dhe krijimit të mbeturinave të rrezikshme.

1.3. Metodologjia

Raporti përcjell strukturën e dhënë me ligjin për VNM i cili përfshin këta kapituj:

- **Përshkrimin e përmbledhur të funksionimit të Thertores:** Përshkrimi përmban informacione lidhur me lokacionin e Thertores dhe qasjen në parcelë, shfrytëzimin aktual të tokës, pronësinë e tokës. Gjithashtu përshkruan karakteristikave kryesore të veprimtarisë së Thertores.
- **Përshkrimi i lokacionit të propozuar**
- **Përshkrimin e aspekteve përkatëse të gjendjes aktuale ku përfshihen:**
 - Gjeologjia, toka dhe ujërat nëntokësor
 - Menaxhimi i ujërave dhe ujërave të zeza
 - Ajri dhe ndryshimet klimatike
 - Zhurma
 - Menaxhimi i mbeturinave
 - Ekologjia dhe biodiversiteti
 - Vendbanimi, popullat dhe çështjet socio-ekonomike dhe tjera
 - Peisazhi dhe ndikimi visual

Përshkrimi i këtyre aspekteve mjedisore ka marrë në konsideratë të dhënat dhe informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme, duke përfshirë:

- Studime të literaturës dhe publikimeve;
- Sondazhet dhe vizita në terren
- Intervista me pronarin dhe palë të interesit

Metodologjia e ndërmarrë për vlerësimin e secilit atribut mjedisor është përshkruar në detaje brenda secilit kapitull.

- **Përshkrimi i alternativave të arsyeshme:** përshkruan skenarin në rastin kur nuk Thertorja do të vazhdojë të punojë pa u pajisur me leje mjedisore si dhe skenarin e kundërt, kur ajo pajiset me të.
- **Përshkrimin e faktorëve të përcaktuar që ka gjasa të ndikohen nga funksionimi i Thertores:** Janë identifikuar faktorët dhe elementët kryesorë që kanë gjasa të ndikohen nga funksionimi i Thertores, duke u bazuar në informacionin e marrë përmes literaturës, anketimit të zhvilluar, hulumtimit si dhe vizitave në terren.
- **Përshkrimi i ndikimit të projektit në mjedis:** Ky kapitull përshkruan ndikimet mjedisore të shkaktuara nga zhvillimi i aktiviteteve të thertores në fazën e tij të operimit pasi që objekti veçse është i ndërtuar dhe përcakton masat e parapara që duhet të ndërmirren për të zvogëluar efektet e këtyre ndikimeve.
- **Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis**
- **Plani i menaxhimit mjedisor**
- **Konkludim:** Përfshin një përmbledhje të gjeturave nga vlerësimi dhe ofron edhe rekomandimet për masat që duhet ndërmarrë nga pronari i Thertores për të përmirësuar rrjedhën e punës dhe cilësinë e produktit.

Përmbledhja joteknike përfshin të gjitha informacionet që përman ky raport vetëm se në formën më të përmbledhur dhe të përshtatur në formën që të kuptohet më lehtë nga publiku. Ofrohet si dokument i veçantë.

2. PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I THERTORËS PËR THERJEN E GJEDHEVE TË TRASHA

2.1. Kategoria e projektit të propozuar

Veprimtaria e Thertores listohet si industri ushqimore, e kategorizuar si Instalimet për therjen e kafshëve (7.6) bazuar në Shtojcën II të Ligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

2.2. Përshkrim i punëve përgatitore për zbatimin e projektit

Meqenëse thertorja është tashmë e ndërtuar, fokusi në këtë veprimtari do të jetë tek përmbushja e standardeve që kryesisht ka të bëjë me përmirësimin e instalimeve teknike, sigurimin e lejes mjedisore dhe respektimin e kërkesave ligjore e higjieno-sanitare. Raporti i VNM-së e përshkruan këtë si një proces që garanton funksionim të ligjshëm dhe të sigurt për mjedisin e përreth.

2.3. Përshkrimi i karakteristikave kryesore të Thertores dhe aktiviteteve të saj

Thertorja bën pjesë në veprimtari me kapacitet shumë të vogël, vetëm 2 deri max.3 therrije në javë. Therja e kafshëve bëhet menjëherë pas arritjes në thertore, dhe për të cilën paraprakisht është siguruar certifikata nga inspektori, prandaj në Thertorja nuk ka hapësirë pritëse apo për çlodhjen para therjes. Thertorja nuk ka hapësirë të ndarë për mbledhjen dhe depozitimin e përkohshëm të materialeve me rreziqe specifike dhe të nënprodukteve të kafshëve tyre (lëkura dhe brendshmet), në pritje të largimit drejt destinacionit përfundimtar pasi që largimi bëhet menjëherë nga operatori "Higjiena" e licencuar për largimin dhe depozitimin e tyre në deponi të veçantë.

Thertorja përbën një biznes vet-punësimi për pronarin dhe familajërt e tij. Ajo ka vetëm një objekt i cili ka këto përmbajtje:

1. Zyra e inspektorit
2. Hapësira ndihmëse (hyrja e personelit) ku bëhet edhe dezinfektimi i duarve para hyrjes në thertore dhe veshja e gardrobës së përshtatshme për punë)
3. Hapësira për therjen e gjedhes

4. Dhoma e ftohjes
5. Toaleti




Figura 3. Baza e Therrtores

1. Zyrja e inspektorit ka hyrje të veçantë, është e vendosur në vend të përshtatshëm me pajisje të mjaftueshme për punë.



Foto 1. Zyrja e inspektorit



Foto 2,3,4: Hapësira e personelit

2. Hapësira ndihmëse (hyrja e personelit) e cila shërben për hyrjen e personelit në thertore dhe është e pajisur me mjete për dezinfektimin e duarve dhe vendosjen e gardërobës së përshtatshme për punë, në përputhje me standardet higjieno-sanitare.

3. Hapësira për therjen e gjedhes: Kjo hapësirë është e dedikuar për procesin e therjes së gjedheve, largimin e organeve të brendshme dhe përgatitjen fillestare të karkasës.




Foto 5&6:
Hapësira
për
therjen e
gjedhes

Në këtë hapësirë operohet me vetëm një linjë therje. Nuk ka hapësirë të veçantë për zbrazjen dhe pastrimin e të brendshmeve dhe zorrëve por nuk ka ndonjë dëshmi nga inspekcioni sanitar si kërkesë për ndarjen e këtyre dy veprimtarive. Megjithatë në kuadër të objektit ka hapësirë të mjaftueshme për një ri-organizim që ta bëjë të mundur këtë ndarje.

Hapësira është e pajisur me pajisje të përshtatshme për trajtimin higjienik të kafshëve. Hapësira përfshin sisteme për rrjedhën lineare të procesit, dysheme të lehtë për pastrim, dhe sistem kanalizimi përmes tre seperatorëve për largimin e mbeturinave të lëngshme (gjakut dhe yndyrës) që rrjedhin nga procesi i pastrimit të kafshës.

Hapësira posedon sistem të ventilimit artificial por jo edhe atij natyror me hapje përmes dritareve.

Hapësira është e pajisur me ambiente të veçanta për dezinfektimin e mjeteve të punës me ujë të nxehtë, dhe pajisje për larjen e duarve, të destinuara për personelin që merret me mishin e ekspozuar, me rubineta dhe vaska të dizajnuara për të parandaluar ndonjë kontaminim të mundshëm.

Foto 7: Hapësira brenda thertores për dezinfektimin e mjeteve të punës me ujë të nxehtë



4. Dhoma e ftohjes: Kjo hapësirë përbëhet nga një frigorifer (komore) e cila ka sistem të ftohjes -2 deri +3 C ku ruhet karkasa deri në marrjen dhe dërgimin e saj në mishtore. Hapësira ka qasje edhe nga jashtë prej nga bëhet largimi i karkasë për t'u larguar deri në mishtoren e cila ndodhet në qytet.



Foto 8, 9 & 10: Hapësira ftohëse




Figura 4. Procesi teknologjik

2.4. Përshkrim detal i procesit të planifikimit të prodhimit

Procesi i prodhimit në thertoren "Freskia" është i organizuar në mënyrë lineare dhe të thjeshtë. Pas arritjes së kafshëve në objekt, therja kryhet menjëherë me praninë e inspektorit veterinar, pa hapësira pritëse. Karkasa përpunohet në sallën e therjes, ku organet e brendshme hiqen dhe

pastrimi kryhet me sisteme kanalizimi të pajisura me tre separatorë për gjak dhe yndyrë. Mjetet e punës dezinfektohen me ujë të nxehtë në ambiente të veçanta, ndërsa personeli përdor garderobë të përshtatshme dhe rubineta të dizajnuara për higjienë. Pas përfundimit të therjes, karkasa ruhet në dhomën e ftohjes me temperaturë -2 deri +3 °C deri në shpërndarje në mishtore. Nënproduktet (lëkura dhe brendshmet) largohen menjëherë nga operatori i licencuar “Higjiena”, duke siguruar menaxhim të kontrolluar të mbeturinave.

2.5. Paraqitja e llojit dhe sasisë së burimeve të nevojshme

Për realizimin e aktiviteteve në thertoren “Freskia”, burimet e nevojshme janë të kufizuara, duke reflektuar kapacitetin e vogël të saj (2–3 therje në javë).

- **Numri i punëtorëve:** Thertorja funksionon si biznes vet-punësimi, ku pronari dhe familjarët e tij kryejnë punën. Përveç tyre, është i domosdoshëm inspektori veterinar që lëshon certifikatën për therje.
- **Burimet materiale:** përfshijnë garderobën e përshtatshme për personel, mjete për dezinfektim, detergjentë dhe produkte higjieno-sanitare.
- **Makineria e nevojshme:** linja e thjeshtë e therjes, pajisjet për pastrimin e brendshmeve, sistemi i kanalizimit me tre separatorë për gjak dhe yndyrë, frigoriferi (dhoma e ftohjes -2 deri +3 °C), si dhe pajisjet për dezinfektimin e mjeteve me ujë të nxehtë.
- **Burimet energjetike dhe ujore:** lidhja me rrjetin energjetik lokal dhe furnizimi me ujë të pijshëm për pastrim dhe dezinfektim.
- **Menaxhimi i mbeturinave:** bashkëpunimi me operatorin e licencuar “Higjiena” për largimin e nënprodukteve shtazore.

2.6. Vlerësimin e gjenerimit të llojit dhe sasisë së mbeturinave, emetimeve gjatë procesit teknologjik dhe prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit dhe asgjësimit të të gjitha llojeve të mbeturinave

Gjenerimi i mbeturinave dhe emetimeve gjatë procesit teknologjik është i lidhur ngushtë me natyrën e aktivitetit dhe kapacitetin e vogël të saj. Llojet e mbeturinave që gjenerohen përfshijnë:

- **Mbeturinat organike:** përfshijnë gjakun, yndyrën, lëkurat dhe organet e brendshme të kafshëve. Këto largohen menjëherë nga operatori i licencuar “Higjiena”, duke shmangur grumbullimin në objekt.
- **Mbeturinat e lëngshme:** trajtohen përmes sistemit të kanalizimit me tre separatorë, të cilët ndajnë gjakun dhe yndyrën nga uji i pastrimit, duke reduktuar ndotjen e ujërave.
- **Emetimet në ajër** që përfshijnë erërat që vijnë nga procesi i therjes dhe pastrimit të kafshëve, si dhe nga ruajtja e karkasës në dhomën e ftohjes
- **Teknologjia e trajtimit:** përfshin dezinfektimin e mjeteve me ujë të nxehtë, pastrimin e dysHEMEVE të lehta për higjienë, si dhe përdorimin e frigoriferit për ruajtjen e karkasës në kushte të kontrolluara.
- **Riciklimi dhe asgjësimi:** mbeturinat shtazore nuk riciklohen në vend, por dërgohen në destinacion të veçantë për trajtim dhe deponim, sipas standardeve ligjore.

2.7. Prezantimi i teknologjisë së trajtimit, përpunimit, riciklimit, asgjësimit të mbeturinave

Mbeturinat e lëngshme trajtohen përmes sistemit të kanalizimit me tre separatorë, që ndajnë gjakun dhe yndyrën nga uji i pastrimit, duke reduktuar ndotjen e ujërave. Pajisjet dhe hapësirat dezinfektohen me ujë të nxehtë, ndërsa frigoriferi siguron ruajtjen e karkasës në kushte të kontrolluara (-2 deri +3 °C). Riciklimi nuk kryhet brenda objektit, por mbeturinat shtazore asgjësohen në mënyrë të sigurt jashtë tij. Ventilimi artificial ndihmon në kontrollin e ajrit dhe uljen e erërave të pakëndshme. Ky kombinim i teknologjisë së trajtimit, përpunimit dhe asgjësimit siguron që thertorja të funksionojë në përputhje me ligjin, duke minimizuar ndikimet negative në tokë, ujë dhe ajër.

2.8. Program për ndërtimin, kohëzgjatjen e funksionimit dhe përfundimit dhe rehabilitimit pas mbarimit të funksionimit të projektit

Ndërtimi: Objekti ekzistues është ndërtuar që nga viti 2002, prandaj nuk parashikohet ndërtim i ri. Fokus kryesor është përmirësimi i instalimeve teknike, ventilimit, kanalizimit me tre separatorë dhe hapësirave higjieno-sanitare. Kohëzgjatja e punimeve për këto përshtatje duhet të jetë e shkurtër (disa javë), duke qenë se objekti është funksional.

Kohëzgjatja e funksionimit: Kohëzgjatja e operimit nuk ka afat të përcaktuar, por varet nga mirëmbajtja dhe përmbushja e kushteve ligjore dhe marrjen e lejes mjedisore për funksionim adekuat.

Përfundimi dhe rehabilitimi: Në rast të mbylljes, objekti duhet të largojë mbeturinat dhe nënproduktet shtazore përmes operatorit të licencuar, të pastrohet dhe dezinfektohet plotësisht. Sistemet e kanalizimit dhe separatorët duhet të çmontohen ose neutralizohen për të shmangur ndotjen. Parcela mund të rikthehet për përdorim bujqësor ose agro-industrial, duke rehabilituar tokën dhe duke e përshtatur sipas Planit Zhvillimor Komunal.

2.9. Të dhëna për infrastrukturën e nevojshme

Meqenëse thertorja “Freskia” është tashmë në funksion dhe nuk është objekt i ri ndërtimi, infrastruktura e nevojshme tashmë është e siguruar: lidhja me rrjetin energjetik lokal, furnizimi me ujë të pijshëm, sistemi i kanalizimit me tre separatorë, dhoma e ftohjes me temperaturë të kontrolluar dhe hapësirat për dezinfektim të mjeteve, si dhe bashkëpunimi me operatorin “Higjiena” për menaxhimin e mbeturinave.

2.10. Të dhëna për aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit si ndërtimi i kampeve apo rezidencave

Objekti i thertores “Freskia” është tashmë i ndërtuar dhe funksional, prandaj nuk ka nevojë për aktivitete shtesë si ndërtimi i kampeve apo rezidencave për zbatimin e projektit.

2.11. Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin

Raporti i VNM-së për thertoren, është hartuar si kërkesë e domosdoshme për pajisjen e objektit me leje mjedisore, duke siguruar që veprimtaria të zhvillohet në përputhje me standardet ligjore dhe higjieno-sanitare, si dhe të garantojë mbrojtjen e mjedisit përreth.


2.12. Informacion për ndërlidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese

Kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për thertoren “Freskia”, pasi objekti është tashmë i ndërtuar dhe funksional dhe nuk ka ndërlidhje me projekte të tjera ekzistuese.

3. PËRSHKRIM I LOKACIONIT TË THERRTORES

3.1. Lokacioni dhe ngastrat kadastrale, pronesi, skica dhe planimetria e vendndodhjes së projektit

Për përshkrimin e lokacionit dhe komponentëve përbërëse të Thertores është përdorur dokumentacioni i ofruar nga pronari: Certifikata e biznesit e cila dëshmon që ky aktivitet është në regjistrin zyrtar të Kosovës, Certifikata e pronës e cila dëshmon që Thertorja gjendet në pronë private të pronarit respektivisht babait të tij; Kopja e planit, Situacioni i terrenit përmes ortofotos dhe hartës topografike të terrenit, hartat nga Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna etj.



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
Ministria e Mbrojtjes dhe Planifikimit Hapësinor / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure
AGJENCIA KADASTRALE E KOMUNES / KATASTRARSKA AGENCIJA KOMUNA / КОГОПКАДАСТРА АГЕНЦИЈА КОМУНА
CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NËMËJA KADASTRALE / KATASTRARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT: P-78505811-08790-0

Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit
Data dhe koha e shprehur / Datum i shprehur / Datum i shprehur
Shtet / Opština / Opština
Zona Kadastrale / Katastrarska Zona / Cadastrol Zone
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastrarska Kancelarija / Municipal Cadastre Office

TE DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTRARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit	Tipi i objektit / Vrsta objekta / Vrsta objekta	Tipi i objektit / Vrsta objekta / Vrsta objekta	Tipi i objektit / Vrsta objekta / Vrsta objekta	Tipi i objektit / Vrsta objekta / Vrsta objekta	Tipi i objektit / Vrsta objekta / Vrsta objekta
P-78505811-08790-0	Parcela	Parcela	Parcela	Parcela	Parcela

ADRESA E NJËSINË KADASTRALE / ADRESA KATASTRARSKOJ JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i objektit / Mesto objekta / Mesto objekta	Kodi Postel / Poštanski Kod / Poštanski Kod	Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit	Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit

LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE							
Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit / Nazari i Shkëlqit	Lloji i shfrytëzimit / Vrsta koriscenja / Type of Use		Shfrytëzimi aktual / përdorimi / Actual Use		Kualiteti i tokës / Kvaliteti tokës / Quality Class		Shprehja (m ²) / Površina (m ²) / Area (m ²)
1	Toka Ndërtimore/Grahdarësi / Izgradnja / Construction land		Toka Ndërtimore/Grahdarësi / Izgradnja / Construction land		Kualiteti i tokës / Kvaliteti tokës / Quality Class		500
2	Bujqësori/Poljoprivreda / Poljoprivreda / Agriculture		Bujqësori/Poljoprivreda / Poljoprivreda / Agriculture		Kualiteti i tokës / Kvaliteti tokës / Quality Class		300
3	Toka Ndërtimore/Grahdarësi / Izgradnja / Construction land		Toka Ndërtimore/Grahdarësi / Izgradnja / Construction land		Kualiteti i tokës / Kvaliteti tokës / Quality Class		300

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR							
Të drejtat / Prava / Rights	Emri i emrit / Ime / Name	Nr. personal / Lic. broj / ID. No.	Vendbanimi / Prebivalište / Residence	Kodi postel / Poštanski kod / Postal code	Detajlet e adresës / Detalji adrese / Address details	Pjesa e pronës / Dio imovine / Share quota	Proshkrimi / Opis / Description
Proshkrimi individual / Individualni Proshkrim / Single possessor	NITAJ NIMAN (HAMÉZ)	KCD050040	VOKSH / VOKSH / VOKSH	40	1/1		

Figura 1. Të dhënat kadastrale mbi pronë dhe llojin e shfrytëzimit të tokës

Thertorja që është subjekt i trajtimit të këtij vlerësimi, është e pozicionuar në periferi të fshatit Voksh, në komunën e Deçanit, i cili sipas Planit Zhvillimor Komunal 2024 -2032 konsiderohet si vendbanim i mesëm rural si dhe nën-qendër ngase ofron disa shërbime si zyra të gjendjes civile, QMF etj. Parcela ku ndodhet objekti është e përshtatshme për veprimtari agro-industriale, me një terren kryesisht të rrafshët dhe me qasje të lehtë nga rrugët lokale. Ajo ndodhet në tokë të përcaktuar ndërtimore dhe në të njëjtën parcelë ku edhe ndodhet shtëpia e pronarit. Sipërfaqja e përgjithshme është 1090m² nga e cila 704 m² është tokë ndërtimore dhe pjesa tjetër e klasifikuar si tokë bujqësore-kullosë e kategorisë 3. Ky përcaktim i shfrytëzimit të tokës e bën të përshtatshme për veprimtari agro-industriale.

Sipas të dhënave kadastrale të komunës, prona dëshmohej lehtë që është pronë private. Pronësia është e regjistruar në emër të babait të pronarit dhe është e dokumentuar me kopje të planit kadastral dhe fletën poseduese (e bashkangjitur me dokumentacionin), e cila përmban të dhënat kadastrale si numrin e parcelës, sipërfaqen, kufijtë dhe pronarin e regjistruar, duke vërtetuar qartë statusin e saj si pronë private pa konteste.

Qasja në parcelë sigurohet përmes një rruge dytësore e cila lidhet me rrugën kryesore që përshkon fshatin Voksh dhe lidh zonën me qytetin e Deçanit. Infrastruktura rrugore është e mjaftueshme për qarkullimin e automjeteve të transportit dhe të pajisjeve të nevojshme për funksionimin e thertores, përfshirë edhe automjetet e furnizimit dhe shpërndarjes.



Figura 2. Harta e lokacionit të gjerë të objektit të Thertores

Parcela është e rrethuar dhe e organizuar në mënyrë që të mundësojë një rrjedhë të rregullt të punës. Rrjeti energjetik dhe qasja në burimet e ujit të këtij lokaliteti e bën këtë vendndodhje funksionale dhe të përshtatshme për veprimtari të përhershme të kësaj natyre.

Fshati Voksh është i përfshirë në kuadër të Planit Hapësinor për zonën e veçantë të mbrojtur “Bjeshkët e Nemuna”, zona 2. Zona e dytë - menaxhimi aktiv, sipas Ligji për Parkun kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” përfshinë pjesët e territorit të Parkut që karakterizohen me ekosisteme, vlera peizazhore dhe vlera tjera të natyrës ku mund të ushtrohen ekoturizmi, bujqësia tradicionale dhe veprimtaritë të cilat nuk janë në kundërshtim me qëllimet e mbrojtjes.

3.3. Distanca me të dhënat për qendrat e banuara në raport me lokacionin ku propozohet të zbatohet projekti

Thertorja ndodhet në një zonë rurale dhe veprimtaria zhvillohet brenda parcelës së pronarit, e izoluar nga ndërtesat fqinje të banimit, me distanca të mjaftueshme që sigurojnë ushtrimin e aktivitetit pa pengesa dhe pa ndikime shqetësuese për komunitetin përreth.

3.4. Karakteristikat pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të terrenit

Terreni ku ndodhet thertorja “Freskia” ka karakteristika pedologjike, gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrogjeologjike dhe sizmologjike të qëndrueshme, tipike për zonën rurale të Deçanit, duke ofruar kushte të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë pa rrezik të veçantë për mjedisin apo sigurinë e objektit. Elaborim më i gjerë i kushteve të tilla është dhënë në kapitullin vijues.

3.5. Të dhënat për burimin e furnizimit me ujë

Burimi i furnizimit me ujë për thertoren është tashmë i siguruar përmes lidhjes me rrjetin lokal të ujësjellësit dhe dy bunareve, duke garantuar ujë të pijshëm për pastrim, dezinfektim dhe nevojat teknologjike të objektit.

3.6. Paraqitja e kërkesave klimatike me tregues të përshtatshëm meteorologjik

Objekti ndodhet në zonë rurale me kushte klimatike të moderuara, ku treguesit meteorologjik si temperaturat mesatare, reshjet e shiut dhe erërat sezonale janë të menaxhueshme dhe nuk

paraqesin rrezik të veçantë për funksionimin e saj, duke lejuar zhvillimin e veprimtarisë në përputhje me standardet mjedisore.

3.7. Prezantimi i karakteristikave natyrore

Prezantimi i karakteristikave natyrore të ndërlidhura me projektin, përfshin elementet bazë të mjedisit përreth si toka, ujërat, ajri dhe biodiversiteti, ndërsa kjo temë është elaboruar më gjerësisht dhe me detaje të plota në kapitullin vijues të raportit.

3.8. Rishikimi i karakteristikave themelore të peizazhit

Objekti është i vendosur në një zonë rurale, brenda parcelës së pronarit, me mjedis të izoluar nga ndërtesat e banimit dhe pa elemente vizuale që krijojnë pengesa, duke u integruar natyrshëm në peizazhin përreth. Elaborim më i gjerë është përshkruar tek kapitulli vijues.

3.9. Rishikimi i objekteve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore dhe historike

Në afërsi të thertores nuk ka objekte që figurojnë në listën e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, prandaj kjo kërkesë nuk është e aplikueshme për projektin.

3.10. Të dhëna për popullsisën përqendrimin e popullsisë dhe karakteristikat demografike në lidhje me projektin e planifikuar

Thertorja vecse është e ndërtuar, ndodhet në fshatin Voksh, një vendbanim i mesëm rural me karakteristika malore, ku popullsia është e shpërndarë dhe me përqendrim të ulët; aktiviteti i thertores zhvillohet brenda parcelës së pronarit, i izoluar nga banesat fqinje, ndërsa sipas PZHK-së fshati ka rreth 620 banorë me projeksion rritjeje deri në 644 banorë në vitin 2031.

3.11. Të dhëna për objektet ekzistuese

Të dhënat për objektet ekzistuese tregojnë se thertorja “Freskia” është një objekt i ndërtuar që nga viti 2002, tashmë funksional dhe i pajisur me hapësirat e nevojshme për therje, ruajtje dhe menaxhim higjieno-sanitar. Në afërsi të saj ndodhet një objekt banimi me banim të përkohshëm, pasi që pronarët e saj jetojnë jashtë vendit si dhe një objekt banimi i shkatërruar gjatë luftës e që është ende i pariparuar.

3.12. Të dhëna për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme, zonat me qëllime të veçanta dhe të ngjashme

Të dhënat për zonat e përcaktuara për kërkime shkencore, vendet arkeologjike, zonat veçanërisht të ndjeshme dhe ato me qëllime të veçanta nuk janë të aplikueshme për thertoren, pasi në afërsi të saj nuk ekzistojnë objekte apo zona të tilla të evidentuara. Thertorja ndodhet në zonën e dytë të Parkut Kombëtar ku sipas Planit lejohen aktivitete të kontrolluara për zhvillim të qëndrueshëm.

3.13. Të dhëna për burimet ujore në sipërfaqen ku realizohet projekti dhe në afërsi të tij

Në parcelën dhe zonën përreth nuk ka burime ujore sipërfaqësore të evidentuara që mund të ndikohen nga veprimtaria e saj.

4. PËRSHKRIMI I ASPEKTEVE MJEDISORE PÛRKATËSE TË GJENDJES AKTUALE

4.1. Gjeologjia, toka dhe shfrytëzimi i tokës

Karakteristika gjeologjike: Pjesa jug perëndimore e komunës ku edhe gjindet fshati Voksh karakterizohet kryesisht nga terren malor dhe kodrinor, me pjerrësi të theksuara dhe lartësi mbi mesataren e komunës. Nga aspekti pedologjik, kjo zonë dominohet nga tokat ranker dhe tokat litosole, të cilat përfaqësojnë toka të cekëta, të zhvilluara mbi formacione shkëmbore, kryesisht gëlqerorë dhe silikatikë. Këto toka kanë profil të dobët të zhvilluar, përmbajnë pak humus dhe kanë kapacitet të kufizuar për mbajtjen e ujit, çka ndikon në uljen e potencialit bujqësor. Për këtë arsye, janë më të përshtatshme për pylltari, kullota dhe në raste të kufizuara për bujqësi të thatë me ndërhyrje agroteknike specifike.

Në disa zona të izoluar, veçanërisht në luginat e vogla dhe zona të mbrojtura nga erozioni, mund të shfaqen tokat deluviale, të cilat janë më pjellore dhe mund të shfrytëzohen për bujqësi në shkallë të kufizuar, kryesisht për kultura të përshtatura për klimën malore.

Në përgjithësi, zona jugperëndimore ka potencial të ulët për bujqësi intensive, por ofron vlera të rëndësishme për ruajtjen e biodiversitetit, turizmin malor dhe menaxhimin e qëndrueshëm të kullotave dhe pyjeve.




Figura 5. Harta pedologjike e komunës së Deçanit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2024-20032)

Karakteristika gjeologjike: Përbërja gjeologjike i takon formacioneve shkëmbore të triasikut të poshtëm-mesëm që përfaqësohet nga seria vullkanogjeno-sedimentare, gëlqerorë, dolomite, serpentinite, diabaze, granite dhe kuarcporfire.¹




Figura 6. Harta gjeologjike e komunës së Deçanit (burimi: Plani Zhvillimor Komunal 2024-20032)

¹ Plani Hapësinor për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna"

Erozioni geomorfologjik: Erozioni është një faktor shumë i rëndësishëm për trajtim sepse kërcënon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën si dhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është e pranishme në pjesën malore/bjeshkë në forma dhe intensitete të ndryshme. Më së shumti është shfaqur si pasojë e degradimit të pyjeve, pjerrtësisë së terrenit, e cila ka ardhë si pasojë e mungesës së mirëmbajtjes përgjatë brigjeve dhe shtretërve të lumenjve, mungesës së pendëve mbrojtëse dhe dëmtimit të masës mbrojtëse vegjetacionit.

Aktualisht janë prezente erozionet natyrore: në Bjeshkët që shtrihen në zonën perëndimore, rrëzë Lumëbardhit dhe Lloqanit (rreth 53 % e sipërfaqes së pellgut është nën erozion) si dhe erozioni i shkaktuar përmes aktiviteteve të njeriut (nxjerrja e zhavorit nga lumenjtë, mosmirëmbajtja e shtretërve të lumenjve, prerja e pyjeve), etj.




Figura 7. Harta e erozionit (burimi: Planit Zhvillimor Komunal 2024-20032)

Sipas hartës së erozionit të Planit Hapësinor të PK të Bjeshkëve të Nemura fshati Voksh është i pozicionuar në një zonë me erozion të ulët, që do të thotë se rreziku nga degradimi i tokës për shkak të erozionit është relativisht i vogël.

“sytë e maleve”. Këta liqene janë burimet kryesore të vlerave mjedisore, turistike dhe ekonomike. Uji shfrytëzohet për pije dhe ujitje, por shtrirja e parregulluar e lumenjve shkakton vërshime dhe dëmton tokat. Pellgjet janë të rrezikuara nga erozioni. Komuna ka disa përroje si: i Durakut, i Strellcit, Behovcit, Vokshit, Gllogjanit, Lëbushës dhe Ratishit.

Vokshi ka disa përrenj por për ujitjen e tokave bujqësore shfrytëzojnë ujin nga Lumbardhi i Lloqanit. Në bjeshkë ndodhen liqene akullnajore (“sytë e maleve”) me vlerë të madhe mjedisore, turistike dhe ekonomike, por ende të pa hulumtuara mjaftueshëm. Në afërsi të objektit të thertrës nuk ka ujëra sipërfaqësore.

Ujërat nëntokësore: Sipas Master Planit për Ujërat e Kosovës 1983-2000, potencialet më të mëdha të ujërave nëntokësore gjinden në rrafshin e Dukagjinit. Por nuk ka hulumtime ende të sakta.

Ndotja e ujit: Uji që furnizon komunën është i pastër në burim, por ndotet gjatë rrugës nga mbeturinat, ujërat e zeza, dhe faktorë bujqësorë si plehrat dhe pesticidet. Ndotja ndikon negativisht në shëndetin e popullatës dhe mjedisin. Gjithashtu, rrjeti i vjetruar i ujësjellësit dhe dëmtimet në të ulin cilësinë dhe sasinë e ujit të pijshëm. Pakësimi i ujit ndikohet edhe nga ndërhyrjet në rrjedhën e lumenjve dhe mungesa e mirëmbajtjes pranë burimeve. Shumica e vendbanimeve të komunës së Deçanit nuk kanë sistem të kanalizimit dhe ujërat e zeza hudhen në lumenj, përrenj. Aktualisht rrjeti i kanalizimit mbulon vetëm 46%² të territorit, pjesa tjetër e komunës për shkak të konfiguracionit gjeomorfologjik kërkon zgjidhje specifike përkatëse për zonë si në rastin e fshatit Voksh i cili ka pozitë kodrinore për të cilin duhet planifikuar trajtim të ndarë. Menaxhimi i rrjetit të ujërave të zeza bëhet nga K.R.U “Hidrodrini” Pejë – Njësia operative Deçan.

Furnizimi lokal me ujë: Qyteti i Deçanit i ka 37 fshatra, ku 35 fshatra mbulohen me rrjetin e ujësjellësit me furnizim 99 % me ujë të pijes. Fshati Voksh, përkatësisht lokacioni ku ndodhet thertrorja furnizohen me ujë nga ujësjellsi me ramje të lirë si dhe dy bunarë.



Foto 11. Bunari para hyrjes në oborrin e Thertrës

Shkarkimi i ujërave të ndotur: Meqë mungon sistemi i kanalizimit, ujërat e ndotura nga Thertrorja derdhen përmes tri bazenave (gypave të betonit) në rrjedhë të përroit më të afërt. Këto ujëra filtrohen në një masë duke kaluar në këto bazene.

² Raporti i Performancës të Komunave 2019

4.3. Ajri dhe rreziqet nga ndryshimet klimatike

Të dhënat për cilësinë e ajrit ofrohen në nivel komune e jo të vendbanimit. Në komunën e Deçanit cilësia e ajrit monitorohet nga stacioni i ajrit në Pejë, nën menaxhimin e AMMK/IHMK. Burimi kryesor i ndotjes me PM10 dhe PM2.5 janë djegiet në ekonomitë familjare, ndërsa për NOx është sektori i transportit. Emetimet në Deçan kryesisht vijnë nga bujqësia dhe pylltaria. Ndotja nga deponitë ilegale është shumë e vogël.

Fshati Voksh nuk përballët me nivele të larta të ndotjes së ajrit. Ndotja e kufizuar që ekziston kryesisht buron nga prerjet ilegale të pyjeve dhe humbja e tokës bujqësore, në një sipërfaqe prej rreth 15–25 hektarësh, si pasojë e ndërtimeve, erozionit dhe faktorëve të tjerë që kontribuojnë në ndryshimet klimatike. Këto fenomene po bëhen gjithnjë e më të dukshme në të gjithë vendin.

Në zonën e Thertores, sipas vëzhgimeve në terren, ndotja e ajrit mund të paraqitet gjatë sezonit dimëror, si rezultat i përdorimit të drurit për ngrohje. Megjithatë, prania e dendur e vegjetacionit në fshat është një tregues pozitiv i cilësisë së mirë të ajrit.

Trafiku në këtë zonë është i kufizuar dhe kryesisht i lidhur me nevojat e banorëve lokalë. Për shkak se fshati ndodhet larg rrugëve kryesore regjionale, ndotja e ajrit nga trafiku është pothuajse e papërfillshme.

4.4. Zhurma

Në komunën e Deçanit nuk ka sistem apo pikë monitoruese për matjen e zhurmës. Sipas PZHK-së, burimi kryesor i zhurmës është komunikacioni si dhe disa aktivitete të subjekteve afariste, që shkaktojnë zhurmë mbi nivelet e lejuara me ligj. Referuar Udhëzimit Administrativ të Kosovës Nr. 08/2009 për vlerat e lejuara të emetimeve të zhurmës nga burimet e ndotjes, vlerat kufitare akustike në fshatra apo zona të përziera janë përcaktuar me 64 dBA gjatë ditës dhe 54 dBA gjatë natës (shih Tabelën e mëposhtme).

Në rastin e fshatit Voksh niveli i ekspozimit të zhurmës është minimal. Edhe Thertorja që është subjekt i këtij raporti nuk paraqet burim të madh të zhurmës së pari për shkak të kapacitetit të vogël që ka, pozitës së saj karshi shtëpive për rreth si dhe vetë organizimit të procesit teknologjik ku kafsha nuk qëndron fare aty por hyn në procesin e therrjes menjëherë pas ardhjes nga egzaminimi i inspektorit.

Tabela 1. Vlerat e lejuara të emetimeve të zhurmës për kategoritë e zonave të përzgjedhura në Kosovë

Mjedisi	Kufinj të lejuar të zhurmës [dB(A)]	
	Ditën, L _d	Natën, L _n
Zona industriale dhe komerciale	69	59
Fshtrat dhe zonat me shfrytëzim të përzier	64	54
Zonat e banimit dhe vendbanimet e vogla	59	49

4.5. Menaxhimi i mbeturinave

Komuna e Deçanit ka krijuar një sistem të organizuar për menaxhimin e mbeturinave në gjithë territorin, i cili realizohet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh.A. Kjo ndërmarrje ofron shërbimin “derë më derë” për ekonomitë familjare në qytet dhe 35 fshatra, ndërsa në fshatrat Belle dhe Pleqe, për shkak të terrenit malor, shërbimi ofrohet sipas planit komunal.

Trajtimi i mbeturinave përfshin mbledhjen, ndarjen, riciklimin, ripërdorimin, kompostimin dhe transportin në deponinë rajonale. Shërbimi mbulon 100% të territorit dhe përfshin 6948 ekonomi familjare, 2,254 biznese dhe 50 institucione. Në komunë ndodhet njësi deponuese e cila ka sipërfaqe

prej 4 ha dhe më zonë mbrojtëse prej 100 m. Ndërsa njësia transferuese është në Sverkë (Komuna e Klinës) me sipërfaqe prej 140 ha dhe zonë mbrojtëse 800 m.

Mbeturinat rregullisht mbledhen edhe në fshatin Voksh -një herë në javë ndërsa mbeturinat nga therrja e kafshëve largohen menjëherë nga NPL "Higijena" sipas marrëveshjes që posedojnë ata me pronarin e Therrtores.

4.6. Ekologjia dhe biodiversiteti

Fshati Voksh, si pjesë përbërëse e territorit të Parkut Kombëtar dhe Komunës së Deçanit, gëzon një rëndësi të veçantë ekologjike për shkak të afërsisë dhe ndërlidhjes me zonat që përmbajnë vlera të larta natyrore dhe biodiversitet të pasur. Sipas hulumtimeve, janë identifikuar 795 lloje bimësh, përfshirë edhe shumë relikte dhe bimë mjekësore si boronica, linsuri, kamomili dhe çajra të tjerë natyrorë. Këto vlera jo vetëm që kontribuojnë në ruajtjen e ekosistemeve, por përbëjnë edhe një pasuri të rëndësishme për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit lokal.

Flora: Në Librin e Kuq të Florës Vaskulare, florën në Komunën e Deçanit, e përbejnë: algat, likenet, kërpudhat, fiernat, farëzhveshurat dhe farëveshurat të cilat janë bazë e jetës, formojnë mbështjellësin e gjelbër të tokës që ka ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e organizmave shtazor dhe njeriut. Pa mohuar rëndësinë e asnjë grupi bimor, që kanë për jetën në planetin tonë, e në kuadër të kësaj edhe për jetën në komunë, bimët vaskulare, në veçanti bimët me farë (farëzhveshurat dhe farëveshurat) kanë rolin kryesor në vegjetacion i cili ka ndikim direkt në klimën, ajrin, ujin dhe tokën.

Fauna: Llojet më të rëndësishme të faunës të cilat gjenden në Librin e Kuq e ku kanë habitat edhe në territorin e Komunës së Deçanit, janë: ariu i murrme (Ursus arctos), shqarthe (Martes foina), vjedulla (Meles meles) etj. Nga llojet e ornitofaunës veçohen: fëllëza e gurëve (Alectoris graeca), pëllumbi i egër (Columba oenas), korbi (Corvus corax), qyqja (Cuculus canorus), qykapikthe i larmë malor (Dryobates leucotos), lauresha e pyjeve (Lullula arborea) etj.

Nga vëzhgimi në terren dhe bazuar në hartën e Parkut kombëtar, Therrtorja ndodhet brenda zonës ndërtimore të fshatit Voksh, është e pozicionuar jashtë zonave me rëndësi të veçantë ekologjike, prandaj nuk paraqet ndikim negativ në biodiversitetin e pasur të rajonit, i cili përfshin lloje të mbrojtura të florës dhe faunës të përmendura më lart. Funksionimi i saj është i kufizuar dhe i kontrolluar, duke respektuar distancat nga zonat natyrore dhe duke shmangur çdo ndërhyrje të drejtpërdrejtë në habitatet natyrore të ndjeshme.

4.7. Vendbanimi, popullata dhe çështjet socio-ekonomike

Fshati Voksh konsiderohet një vendbanim i mesëm rural me karakteristika malore dhe bën pjesë në zonën e dytë të regjimit mbrojtjes së Parkut Kombëtar. Kjo zonë është e dedikuar për pushim aktiv dhe rekreacion të popullsisë, duke ruajtur një balancë ndërmjet ruajtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Në këtë zonë lejohen disa aktivitete të kontrolluara, si: bujqësia me përdorim të kufizuar të pesticideve, herbicideve dhe plehrave azotike; prerja sanitare e pyjeve për nevoja të banorëve dhe për parandalimin e zjarreve; ripyllëzimi në hapësira të dëmtuara pa ndikuar pyjet ekzistuese; zhvillimi i blegtorisë ekstensive, duke përfshirë mbajtjen dhe kullotjen e kontrolluar të kafshëve; bletaria dhe vjelja sezonale e frutave të imta dhe bimëve mjekësore. Gjithashtu, lejohet kultivimi i frutave që nuk konkurrojnë me ato ekzistuese, ndërtimi i shtigjeve për skijim dhe shetitje, instalimi i ski-liftave, teleferikëve dhe shtyllave të energjisë elektrike. Mund të zhvillohen aktivitete rekreative si skijimi, çiklizmi dhe ecja. Ndërtimi i rrugëve është i lejueshëm vetëm në funksion të lidhjes me zonën e tretë. Përdorimi i resurseve ujore është i kufizuar deri në lartësinë 2000 metra për furnizim me ujë, përmes burimeve natyrore apo puseve me infrastrukturë përcjellëse. Lejohet ndërtimi i

akumulacioneve të vogla për blegtori dhe raste emergjente. Me leje të veçantë mund të kryhen hulumtime minerare, por ndalohet çdo lloj operimi i minierave nëntokësore apo sipërfaqësore. Gjithashtu, mundësohet ndërtimi i spitaleve me karakter specifik, si për trajtimin e sëmundjeve kardiovaskulare apo të mushkërive, gjithmonë me leje të autoriteteve kompetente.

Përbëhet kryesisht nga objektet e banimit, stanet dhe objektet tjera me zhvillime të caktuara (aktivitetet, komerciale ose shërbyese).

Sipas PZHK-së ka rreth 620 banorë dhe projeksionet për rritjen e popullsisë deri në vitin 2031 janë 644 banorë.

Punësimi dhe të ardhurat/Ekonomia dhe mjetet e jetesës: Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin ekonomik ndërsa në anën tjetër zona malore është potencial i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm. Po ashtu zhvillohen mjaft ndërmarrjeve individuale, tregti, industrinë e lehtë, gjithashtu resurset e trashëgimisë natyrore dhe kulturore ofrojnë mundësi të mire për zhvillimin ekonomik lokal. Nuk ka informacione mbi numrin e të punësuarve por kryesisht mirren me veprimtari bujqësore. Shumë nga banorët kanë migruar por vazhdojnë të investojnë në fshat.

Shëndeti dhe siguria e punëtorëve në vendin e punës: Fshati Voksh ofron shërbime shëndetësore në QMF.

Infrastruktura e transportit dhe shërbimet publike: Komuna e Deçanit, karakterizohet me lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor të cilat ndihmojnë zhvillimin e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave. Në Komunën e Deçanit, ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve duke filluar prej rrugëve nacionale, regjionale, lokale të pa kategorizuara. Lidhja me fshatin Voksh bëhet përmes rrugës regjionale (R9). Zona ku ndodhet thertorja Freskia lidhet përmes rrugës Xhavit Nitaj me rrugën që të shpie në Deçan ku gjindet mishtorja që furnizohet nga kjo therrtorë.

Komuna ofron shërbim të transportit publik nga operatorët privat me linjat në zonat e ndryshme urbane, rurale dhe ndërkufitare. Gjithashtu planifikohet që në pjesën perëndimore të aktivizohet “shuttle-bus” i cili është mjet transportues ekologjik dhe do të jetë në dispozicion të vizitorëve të për këtë zonë.

4.8. Peizazhi dhe ndikimi vizual

Falë gjeomorfologjisë së saj komplekse, komuna e Deçanit ofron një shumëllojshmëri të pasur peizazhesh natyrore. Aty përfshihen pyje të dendura me bukuri skenike, lugina të formuara nga akulli, depozita morenike, forma karstike, shpella, maja malore, liqene akullnajore, kullosa alpine dhe peizazhe të bukura përgjatë lumenjve. Ndër tiparet më madhështore janë “Gryka e Deçanit” me “Kanonin e Lumëbardhit” dhe “Gryka e Lloqanit” me “Lumëbardhin e Lloqanit”, të cilat ofrojnë mundësi të jashtëzakonshme për ekskursione, si dhe për vizita nga turistë vendas e të huaj.

Lokacioni në të cilin gjindet thertorja Freskia ka një peisazh të bukur natyror i cili nuk degradohet me zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të cilat i plotësojnë standardit mjedisore.

5. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TË ARSYESHME

4.1. Skenari "Pa Leje mjedisore"

Nëse thertorja nuk pajiset me leje mjedisore, funksionimi i saj mund të ketë pasoja të shumta ligjore, mjedisore dhe ekonomike.

- **Ligjore:** Thertorja operon pa përmbushur kushtet e përcaktuara nga legjislacioni mjedisor;
- **Mjedisore:** ndikime negative në mjedis (ndotje e ujërave ose e tokës), nëse nuk përmbushen standardet optimale mjedisore

- **Ekonomike:** Klientët dhe partnerët mund të humbin besimin për shkak të operimit të paligjshëm; Pa leje mjedisore, Thertorja nuk mund të aplikojë për licenca eksporti, apo mbështetje zhvillimore nga institucionet vendore apo ndërkombëtare (p.sh. grante që kërkojnë përputhje me standardet mjedisore).

5.2. Skenari "Thertore që plotëson kushtet mjedisore"

Një Thertore e pajisur me leje mjedisore ka këto përfitime:

- **Ligjore:** Pajisja me leje mjedisore e bën veprimtarinë e Thertores plotësisht të ligjshme dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit mjedisor në fuqi. Kjo i mbron pronarët nga gjrobat, mbyllja e aktivitetit apo procedurat ndëshkuese.
- **Mjedisore:** Zbatimi i masave të kërkuara nga leja mjedisore ndihmon në uljen e ndotjes së ujit dhe tokës dhe në parandalimin e rreziqeve për shëndetin e punonjësve dhe banorëve përreth. Me masa të qarta për menaxhimin e mbeturinave shtazore, ujërave dhe ndotjes, Thertorja siguron një funksionim efikas dhe të qëndrueshëm, duke reduktuar rreziqet teknike dhe mjedisore që mund të ndikojnë negativisht në biznesin afatgjatë.
- **Ekonomike:** Një biznes që punon me standarde mjedisore fiton besim më të madh nga konsumatorët, partnerët dhe komuniteti. Kjo e ndihmon Thertoren të ndërtojë një imazh pozitiv si operator përgjegjës. Shumë fonde zhvillimore, grante bujqësore apo programe mbështetëse kërkojnë që bizneset të kenë dokumentacion të rregullt mjedisor. Leja mjedisore mundëson aplikimin për mbështetje financiare kombëtare dhe ndërkombëtare.

6. PËRSHKRIMI I NDIKIMIT TË THERTORES NË MJEDIS

6.1. Përshkrimi i metodave apo dëshmive të parashikimit

Për vlerësimin e ndikimeve që mund të shkaktojë veprimtaria e Thertores, është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, e cila lejon analizimin dhe krahasimin e ndikimeve mjedisore në kuadër të VNM-së në parametrat si toka, uji, ajri, biodiversiteti, peizazhi si dhe aspektet sociale që lidhen me vendbanimin dhe popullsinë locale.

Duke qenë se Thertorja është objekt i ndërtuar dhe operon që nga viti 2005, janë përdorur kritere të përgjithshme për vlerësimin e ndikimeve të mundshme. Ky vlerësim është bazuar në legjislacionin kombëtar, vizita në terren, konsultime me pronarin dhe palët tjera të interesit, të kombinuara me përvojën profesionale dhe gjykimin teknik. Të dhënat e mbledhura janë analizuar për të identifikuar fushat më të ndjeshme dhe për të zhvilluar masa zbutëse të përshtatshme.

Në përcaktimin e nivelit të rrezikut dhe ndikimit potencial, janë marrë parasysh faktorë si natyra dhe madhësia e veprimtarisë së Thertores, ndjeshmëria e mjedisit përreth, si dhe afërsia me receptorë të ndjeshëm si popullsia, ujërat nëntokësore dhe elementët e biodiversitetit. Kjo qasje siguron që veprimtaria e Thertores të zhvillohet në përputhje me standardet mjedisore, duke minimizuar ndikimet negative dhe duke kontribuar në një menaxhim të qëndrueshëm të saj.

6.2. Përshkrimi i faktorëve që ka gjasa të ndikohen nga projekti

Veprimtaria e Thertores mund të ndikojë në disa faktorë mjedisorë dhe shoqërorë, përfshirë popullsinë lokale dhe shëndetin e saj, për shkak të ndotjes së mundshme të tokës apo ujit. Po ashtu, ndikimi mund të shtrihet edhe në florën dhe e zonës, vlerën kulturore, peizazhin natyror, si dhe tek familjarët e pronarit që janë punëtorë të përfshirë në veprimtarinë e Thertores. Megjithatë, duke ndërmarrë masa parandaluese dhe zbutëse në përputhje me standardet përkatëse, ndikimi në këta faktorë është vlerësuar të jetë minimal dhe i menaxhueshëm.

6.3. Përshkrimi i ndikimeve të projektit në mjedis dhe i masave të parapara

Thertorja në fjalë është tashmë e ndërtuar dhe funksionale, prandaj nuk parashikohen ndikime mjedisore të lidhura me fazën e ndërtimit, siç janë ndotja nga punimet ndërtimore, zhurma, pluhuri apo ndërhyrjet në truall. Të gjitha ndikimet e mundshme janë të lidhura vetëm me fazën e funksionimit të saj, të cilat janë të kufizuara dhe të menaxhueshme përmes masave përkatëse mbrojtëse dhe standardeve të zbatueshme ligjore.

6.3.1. Ndikimi në tokë dhe shfrytëzim të tokës

Veprimtaria e thertoreve të gjedhëve ka ndikime të konsiderueshme në tokë, sidomos kur menaxhimi i mbeturinave dhe ujërave të ndotura nuk është i duhur. Këto ndikime mund të çojnë në degradim të tokës, ndotje dhe pasoja afatgjata për mjedisin dhe shfrytëzimin e tokës.

Thertorja në fjalë ndodhet brenda parcelës së pronarit, pa shtrirje apo ndërhyrje jashtë saj, çka eliminon mundësinë e ndikimeve në tokat përreth apo krijimin e cfarëdo trysnie në shfrytëzimin e tokës. Fshati Voksh gjendet në kuadër të zonë së Parkut Bjeshkët e Nemuna, toka është bujqësore e klasit të tretë, por veprimtaria e këtij biznesi zhvillohet në kuadër të zonës ndërtimore ku lejohet një veprimtari e tillë.

Pronari ka ndërtuar një sistem të trajtimit dhe kullimit të mbeturinave të lëngshme përpara shkarkimit (ujërat nga pastrimi i gjakut, të brendshmeve, ujërat për pastrimin e hapësirës pas therjes) përmes tri bazeneve për të izoluar dhe parandaluar ndotjen e tokës apo. Mbeturinat e ngurta të krijuara gjatë procesit të përgatitjes së karkasave (edhe pse në sasi të vogël-2-3 gjedhe në javë) nuk deponohen; ato largohen menjëherë nga kompania "Higjiena" me të cilën pronari ka kontratë. Sipas pronarit, kohëve të fundit ka interesim të shtuar për marrjen e tyre në vend nga personat mbajtës të kafshëve shtëpiake. Mbeturina organike nuk ka pasi që pas ekzaminimit nga inspektori, me ardhjen e gjedhes në Thertore, bëhet therja e menjëhershme e saj.

Si përfundim, mund të thuhet se ndikimi në tokë konsiderohet minimal dhe plotësisht i menaxhueshëm, falë masave të vazhdueshme që janë ndërmarrë nga investitori.

Masat zbutëse: Rekomandohet të vazhdohet me mirëmbajtje e rregullt dhe vazhdimësi në zbatimin e një sistemi efikas për trajtimin e mbeturinave të ngurta dhe të lëngshme, duke përfshirë grumbullimin, ndarjen, ruajtjen e përkohshme në kushte të përshtatshme dhe transportimin e tyre drejt pikave të autorizuar për përpunim apo asgjësim. Kjo është e domosdoshme për të parandaluar ndotjen e tokës apo degradimin e saj si dhe për të siguruar përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe legjislacionin në fuqi.

6.3.2. Ndikimi në ujërat sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe menaxhimi i ujërave të ndotura

Veprimtaria Thertores mund të ketë ndikim të konsiderueshëm në ujë, atëherë kur ujërat e përdorura teknologjike (uji për pastrimin e trupave të kafshëve, pastrimin e dysHEMEVE, veglave dhe pajisjeve, trajtimin e lëkurës) bëhen mbeturinë dhe përmbajnë gjak, yndyrna, proteina, jashtëqitje, urinë, mbeturina detergjentësh dhe dezinfektuesish. Nëse ky ujë derdhet pa trajtim, ndot ujërat sipërfaqësore apo burimet nëntokësore. Thertorja ndodhet në një lokacion ku s'ka prani të rrjedhave të ujërave sipërfaqësorë, përroi më i afërt është 2 km' larg prandaj ujërat sipërfaqësorë nuk mund të ndikohen drejtpërdrejt nga funksionimi i saj. Në lokacionin e Thertores ka prani të ujërave nëntokësë, aty shumë pranë ka edhe bunar, i cili mund të ndotet në rast se ujërat teknologjik që rezultojnë nga proceset e lartpërmendura nuk arrijnë të menaxhohen dhe asgjësohen në mënyrë të kontrolluar. Mirëpo meqenëse pronari ka ndërmarrë masa parandaluese me punimin e sistemit të izoluar të trajtimit të ujërave të ndotura, me ndërtimin e tri bazeneve të izoluar për grumbullimin e këtyre

ujërave, prandaj mund të konkludojmë se përderisa ky system të kontrollohet duhet, ndikimi në ujë pritet të jetë minimal dhe i menaxhueshëm.

Masat zbutëse: Mirëmbajtja nën kontroll e bazeneve të izoluar për grumbullimin e ujërave të ndotura, filtrimi dhe dezinfektimi i ujit përpara shkarkimit, si dhe monitorim periodik.

6.3.3. Ndikimi në ajër dhe nga rreziqet e ndryshimeve klimatike

Ndotja e ajrit mund të ndodhë në rast të mungesës së kujdesit ndaj menaxhimit të mbeturinave të kafshëve pas procesit të therjes, veçanërisht nëse ato hidhen në ambient të hapur. Kjo mund të shkaktojë përhapjen e aromave të pakëndshme dhe ndotje të ajrit përreth.

Thertorja që është subjekt i këtij vlerësimi, është e pozicionuar në një zonë të izoluar, larg shtëpive të afërta. Për më tepër, banorët më të afërt jetojnë jashtë Kosovës dhe e frekuentojnë zonën vetëm gjatë pushimeve verore, duke zvogëluar më tej rrezikun e shqetësimit për komunitetin lokal. Për rrjedhojë, ndikimi në cilësinë e ajrit vlerësohet të jetë minimal dhe nuk parashikohen përkeqësime lokale, për sa kohë që proceset operationale dhe menaxhimi i mbeturinave realizohen në përputhje me standardet dhe praktikat mjedisore të përcaktuara.

Nga ana tjetër, mungesa e ajrosjes natyrale në objekt paraqet një mangësi potenciale, e cila mund të ndikojë negativisht gjatë procesit të punimit të karkasave. Pa qarkullim adekuat të ajrit, mund të grumbullohen erëra të pakëndshme, lagështi dhe nxehtësi, të cilat jo vetëm që krijojnë kushte të papërshtatshme pune për personelin, por gjithashtu rrisin rrezikun për kontaminim të produktit dhe përkeqësim të kushteve higjieno-sanitare brenda objektit. Kjo e bën të domosdoshme zbatimin e zgjidhjeve teknike për ajrosje artificiale apo ventilim të kontrolluar, në përputhje me standardet për siguri ushqimore dhe mbrojtje të mjedisit të brendshëm.

Rreziqet klimatike që mund të ndikojnë në objektin ose zonën ku ai ndodhet përfshijnë: erëra të forta dhe stuhi, thatësira, si dhe reshje të dendura shiu. Në lidhje me erërat dhe stuhitë, objekti është i mbrojtur me barriera natyrore, falë relievit të përthyeshëm kodrinor të lagjes, ashtu edhe fizikisht, përmes një gardhi të qëndrueshëm mbrojtës. Edhe pse objekti nuk ka izolim termik të plotë, rreziku nga temperaturat e larta është i menaxhueshëm falë sistemit të klimatizimit të instaluar në objekt. Rreziku nga shirat e rrëmbyeshëm brenda parcelës konsiderohet i ulët, pasi pjerrësia natyrore e terrenit lejon largimin efikas të ujërave të akumuluar.

Në përgjithësi, ndikimi në cilësinë e ajrit dhe rreziqet klimatike vlerësohen si minimalë dhe të menaxhueshëm, falë vendndodhjes së izoluar të Thertores, masave mbrojtëse të zbatuara dhe menaxhimit të përshtatshëm të mbeturinave dhe karakteristikave të relievit.

Masat zbutëse: Edhe pse mbeturinat e ngurta gjatë përgatitjes së karkasave largohen menjëherë, rekomandohet që hapësira rezervë në dispozicion të Thertores të jetë e përgatitur për depozitim të përkohshëm të tyre, në rastet kur kompania përgjegjëse për grumbullimin vonohet ose nuk vjen në të njëjtën ditë. Duhet të sigurohet monitorim i rregullt i dezinfektimit ditor të hapësirave të punës dhe zbatimi i rregullave higjienike.

Gjithashtu, të garantohet ventilim i mirë natyral përmes hapjes së dritareve në dhomën e therjes, për të mundësuar qarkullimin e ajrit të pastër. Struktura e objektit duhet të përforcohet për t'u mbrojtur nga kushtet ekstreme atmosferike, përfshirë mbylljen e hapësirave të pambuluara në pjesën e kulmit.

6.3.4. Ndikimi nga zhurma

Në rastin e thertoreve, burimet kryesore të zhurmës përfshijnë zërat e gjedhëve gjatë trajtimit dhe therjes, funksionimin e makinerive dhe pajisjeve teknologjike, si dhe lëvizjen e kamionëve gjatë sjelljes së kafshëve dhe largimit të karkasave.

Thertorja e shqyrtuar në këtë vlerësim është një biznes familjar me kapacitet shumë të ulët, duke përpunuar vetëm 2-3 gjedhë në javë. Veprimtaria ka natyrë të qetë e cila nuk përfshin pajisje apo procese me nivele të larta zhurme. Gjerdhet nuk qëndrojnë në thertore, por hyjnë menjëherë në procesin e therjes. Sipas pronarit, fillimisht bëhet trulllosja e kafshës dhe më pas therja, gjë që minimizon ndjeshëm mundësinë për krijimin e zhurmës shqetësuese. Orari i punës me një ndërrim të vetëm prej 8 orësh gjatë ditës, përkon me kohën kur edhe banorët janë aktiv dhe zhurma është më pak shqetësuese për ta. Gjatë fundjavës nuk punohet. Për më tepër, objekti nuk ndodhet në një zonë me dendësi të madhe banimi dhe shtëpitë përreth janë të pabanueshme. Si rezultat, ndikimi i zhurmës për komunitetin përreth, përfshirë edhe atë që shkaktohet nga transporti, konsiderohet i papërfillshëm.

Masat zbutëse: Meqenëse ndikimi është i papërfillshëm, nuk ka nevojë për masa zbutëse, përveçse monitorim i rregullt i përmbushjes së kërkesave ligjore dhe standardeve mjedisore që lidhen me ndotjen akustike.

6.3.5. Ndikimi në biodiversitet (florë dhe faunë) dhe ekosistem

Veprimtaria e thertoreve gjedhësh mund të ketë ndikim në florën dhe faunën lokale atëherë kur aktiviteti zhvillohet pa masa të duhura mbrojtëse për mjedisin. Këto ndikime mund të jenë të drejtpërdrejta (p.sh., përmes ndotjes) ose të tërthorta (p.sh., përmes ndryshimit të ekosistemit).

Objekti ndodhet brenda kufirit ndërtimor të fshatit dhe nuk është i prirur të shkaktojë dëmtime në biodiversitet meqenëse flora e pranishme është e përshtatur me mjediset njerëzore. Ujërat e ndotura që dalin nga thertorja menaxhohen përmes sistemit të izoluar të trajtimit, mbeturinat ngurta të thertores nuk hidhen në tokë por largohen menjëherë përmes operatorit të angazhuar nga pronari për t'u deponuar në deponi të caktuar, veprimtaria e thertores është e qetë për shkak të kapacitetit të saj të ulët dhe nuk përfshin lëvizje të mjeteve të rënda, makineri apo tinguj të fortë nga kafshët të cilat do të mund shkaktojnë ndonjë stres apo ndryshim të sjelljes tek shpendët dhe gjitarët e vegjël që janë present në këtë zonë apo të kenë ndikim në habitatin natyror. Fshati Voksh është i përfshirë në Planin për zonën e veçantë të mbrojtur të Bjeshkëve të Nemuna, por siç u potencua edhe më lart, Thertorja është në kuadër të kufirit ndërtimor të vendbanimit (zona e tretë e planit) ndaj veprimtaria e saj nuk është e ndaluar. Bazuar në analizën e kushteve ekzistuese dhe natyrën e aktivitetit të Thertores, ndikimi në florën, faunën është i kufizuar dhe i menaxhueshëm, pa pasoja të pakthyeshme për ekosistemin apo biodiversitetin.

Masat zbutëse: të vazhdohet me trajtimin e sigurt të mbeturinave të lëngshme dhe ngurta, të vëzhgohet rregullisht i zonës natyrore përreth për ndikim të mundshme dhe trajtimi i stafit për praktika mjedisore të qëndrueshme.

6.3.6. Ndikimi nga mbeturinat

Në funksion të operimit të Thertores në fshatin Voksh, menaxhimi i mbeturinave paraqet një komponent të domosdoshëm për mbrojtjen e mjedisit dhe përmbushjen e kërkesave ligjore të aplikueshme. Edhe pse volumi i mbeturinave të gjeneruara është i kufizuar, për shkak të natyrës së aktivitetit, trajtimi dhe menaxhimi i duhur i tyre është thelbësor për të parandaluar ndotjen e mjedisit dhe për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të kapacitetit.

Mbeturinat e gjeneruara përfshijnë kryesisht mbeturina organike të kafshëve (gjedhëve), të cilat grumbullohen dhe vendosen në kontejnerë të dedikuar, në përputhje me kërkesat teknike. Për menaxhimin dhe bartjen e këtyre, operuesi i thertores ka nënshkruar kontratë bashkëpunimi me Ndërmarrjen Lokale “Higjiena” Sh.A., e cila kryen largimin e tyre në përputhje me një orar të dakorduar paraprakisht. Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave bëhet në varësi të numrit të gjedhëve të therur, që zakonisht varion nga dy deri në tre njësi në javë.

Sa i përket mbeturinave komunale të amvisërisë, ato menaxhohen njëjtë si për pjesën tjetër të vendbanimit, me grumbullim një herë në javë në pikat e përcaktuara nga kompania përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave në nivel komunal.

Të gjitha procedurat e përshkruara janë në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturinat, si dhe me aktet nënligjore përkatëse, përfshirë Rregulloren dhe Planin Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave. Si rrjedhojë, menaxhimi i mbeturinave në këtë Thertore vlerësohet si i kontrolluar, në përputhje me standardet mjedisore dhe pa ndikime të dëmshme për mjedisin, duke kontribuar në ruajtjen e cilësisë së ambientit dhe respektimin e legjislacionit në fuqi.

Masat zbutëse: Të vazhdohet me masat për parandalim si: forcimi i kontrollit mbi grumbullimin dhe ruajtjen e mbeturinave organike në kontejnerë të përshtatshëm, garantimi i transportit të rregullt në bashkëpunim me ndërmarrjen përgjegjëse, sigurimi i përputhshmërisë me legjislacionin përkatës mjedisor si dhe përshtatja e frekuencës së grumbullimit të mbeturinave me kapacitetin real të thertores për të shmangur akumulimin dhe ndotjen e mundshme. Duke qenë se objekti disponon hapësirë të mjaftueshme, rekomandohet të bëhet një riorganizim i brendshëm për të krijuar një zonë të dedikuar për mbajtjen e përkohshme të mbeturinave të ngurta të gjeneruara nga procesi i therjes, veçanërisht në periudha me ngarkesë të shtuar si gjatë festave, kur kapaciteti i punës rritet përtej niveleve të zakonshme.

6.3.7. Vendbanimi, popullata dhe çështjet socio-ekonomike

Veprimtaria e një thertoreje gjedhësh ka mundësi të ndikojë në vendbanimin dhe popullsinë përreth, veçanërisht kur është e vendosur pranë zonave të banuara dhe kur mungojnë masat e duhura për mbrojtjen e mjedisit. Këto ndikime mund të jenë shëndetësore, sociale, ekonomike dhe psikologjike dhe mund të jenë burim pakënaqësie apo konflikt mes komunitetit lokal dhe biznesit.

Thertorja e shqyrtuar në këtë vlerësim ndodhet brenda parcelës së pronarit, pa shtrirje apo ndikim jashtë saj. Shtëpitë më të afërta janë të banueshme vetëm gjatë sezonit të verës dhe me raste edhe gjatë festive të fundvitit, ndërsa me shtëpinë e vetme të banuar gjatë gjithë vitit, e cila ndodhet në anën lindore të objektit, ekziston një distancë e mjaftueshme për të mos shkaktuar shqetësime. Sipas pronarit, marrëdhëniet me fqinjët janë të mira dhe nuk janë paraqitur ankesa lidhur me aktivitetin e thertores. Aktiviteti nuk ndikon në cilësinë e jetës në vendbanim. Bëhet fjalë për një biznes të vogël familjar, ku të gjithë të punësuarit janë anëtarë të familjes, dhe mishi i përpunuar në mishtoren në qytetin e Deçanit shitet vetëm brenda komunës, për nevoja të kufizuara lokale, pa synuar tregun më të gjerë.

Si përfundim, nga pikëpamja sociale dhe ekonomike, kjo veprimtari ndikon pozitivisht në mirëqenien lokale, pa shkaktuar konflikte apo pasoja për komunitetin, prandaj ndikimi mund të vlerësohet si i papërfillshëm.

Masat zbutëse: pavarësisht ndikimit të papërfillshëm, për të ruajtur këtë gjendje dhe parandaluar çdo shqetësim të mundshëm, rekomandohen këto masa zbutëse: Ruajtja e marrëdhënieve të mira me fqinjët përmes komunikimit të hapur dhe reagimit ndaj çdo ankese eventuale, kufizimi i aktiviteteve

me potencial shqetësues (si zhurma ose transporti) gjatë orëve të pushimit për banorët përreth dhe njoftimi paraprak i komunitetit në rast të ndonjë ndryshimi në shkallën ose mënyrën e operimit të aktivitetit.

6.3.8. Peisazhi dhe ndikimi vizual

Peizazhi natyror dhe ai i ndërtuar i vendbanimit, mund të ndikohet kur thertorja vendoset ose operon në mënyrë të pakontrolluar, pa integrim estetik dhe ekologjik me zonën përreth. Ndikimet në peizazh nuk janë vetëm vizuale, por përfshijnë edhe ndikime ekologjike, kulturore dhe sociale.

Thertorja në fjalë është e integruar brenda parcelës së shtëpisë së pronarit dhe nuk përbën një ndërtim të madh apo me struktura betoni ose metali që do të ndikonte negativisht në peizazhin natyror. Thertorja nuk gjeneron mbeturina që shkaktojnë ndotje vizuale apo erë të pakëndshme dhe nuk ndikon në zvogëlimin e gjelbërimit në lokalitet. Përballë fasadës ballore ndodhet një kullë guri, monument me vlera të trashëgimisë kulturore, e cila pavarësisht dëmtimeve të shkaktuara gjatë luftës, mbetet pjesë e rëndësishme e identitetit historik të onës. Ndikimi estetik i Thertoresh është i kufizuar dhe lidhet kryesisht me mungesën e fasadimit të objektit.

Edhe pse ndikimi vizual dhe peizazhor është minimal, pronarit i rekomandohet të ndërmarrë masa për të ruajtur dhe përforcuar identitetin vizual dhe historik të zonës, të përmirësojë efikasitetin e energjisë të objektit dhe të kontribuojë në harmonizimin e ndërtesës me peizazhin lokal.

Masat zbutëse: Rekomandohet ndërmarrja e masave për rritjen e efikasitetit të energjisë, përfshirë termozolim dhe objektit sipas standardeve përkatëse, çka do të ndikonte pozitivisht në uljen e konsumit të energjisë, sidomos për ftohje gjatë verës. Gjithashtu, sugjerohet fasadimi i ndërtesës me ngjyrë dhe materiale që respektojnë karakterin lokal, duke përmirësuar pamjen vizuale dhe integrimin me peizazhin përreth. Mbjellja e gjelbërimit përballë fasadës perëndimore do të ndihmonte në reduktimin e ngrohjes së objektit gjatë verës, si dhe do të shërbente si element estetik dhe filtër natyror për mjedisin.

Tabela 2: Tabela përmbledhëse e efekteve dhe masat zbutëse

Aspekti mjedisor	Efekti i ndikimit të thertoresh	Masat zbutëse
Toka dhe shfrytëzimi	Rrezik degradimi dhe ndotjeje nga mbeturinat e lëngshme dhe të ngurta. Ndikimi vlerësohet minimal falë sistemit të trajtimit dhe kontratës me operatorin "Higjiena".	Mirëmbajtje e rregullt e sistemit të trajtimit; ndarje dhe transport i mbeturinave drejt pikave të autorizuar; respektim i standardeve higjieno-sanitare.
Ujërat sipërfaqësore/nën tokësore	Rrezik ndotjeje nga ujërat teknologjike (gjaku, yndyrna, detergjentë). Ndikimi minimal falë tri bazeneve të izoluar.	Mirëmbajtje e bazeneve; filtrim dhe dezinfektim i ujit para shkarkimit; monitorim periodik.
Ajri dhe ndryshimet klimatike	Mundësi erërash të pakëndshme dhe kushte jo të përshtatshme pune për personelin. Ndikimi minimal për shkak të vendndodhjes së izoluar.	Ventilim natyral dhe artificial; dezinfektim i rregullt i hapësirave; përforsim i strukturës kundër kushteve atmosferike ekstreme.
Zhurma	Zhurmë e papërfillshme për shkak të kapacitetit të vogël (2–3 gjedhe në javë) dhe distancës nga banorët.	Nuk kërkohen masa shtesë, vetëm monitorim i përpunës me ligjin për ndotjen akustike.
Biodiversiteti dhe ekosistemi	Ndikim i kufizuar, pa pasoja të pakthyeshme, falë menaxhimit të mbeturinave dhe kapacitetit të ulët.	Trajtim i sigurt i mbeturinave; vëzhgim i zonës përreth; trajnimi i stafit për praktika të qëndrueshme.

Mbeturinat	Gjenerim i kufizuar mbeturinash organike; menaxhim i kontrolluar përmes kontratës me “Higjiena”.	Kontroll mbi grumbullimin dhe ruajtjen; transport i rregullt; krijim i zonës për mbajtje të përkohshme gjatë periudhave me ngarkesë të shtuar.
Vendbanimi dhe aspektet socio-ekonomike	Ndikim pozitiv në punësim dhe mirëqenie lokale; pa ankesa nga komuniteti.	Ruajtje e marrëdhënieve të mira me fqinjët; kufizim i aktiviteteve shqetësuese; njoftim paraprak për ndryshime në operim.
Peizazhi dhe ndikimi vizual	Ndikim minimal, objekt i vogël i integruar në parcelën e pronarit; mungesë fasadimi.	Termoizolim i objektit; fasadim me materiale lokale; mbjellje gjelbërime për harmonizim estetik dhe ekologjik.

6.3.9. Përshkrimi i cënueshmërisë së objektit të thertores ndaj aksidenteve dhe/ose katastrofave që ndërlihen me funksionimin e tij

Aksidentet apo katastrofat në një thertore gjedhësh janë ngjarje të paparashikuara që mund të dëmtojnë mjedisin, shëndetin publik, si dhe sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve në vendin e punës. Ato zakonisht ndodhin si pasojë e gabimeve njerëzore, defekteve teknike apo fatkeqësive tjera.

Në kuadër të kësaj thertoreje, aksidentet e mundshme mund të përfshijnë: avari në rrjetin e energjisë, defekte në dhomat frigoriferike, rrjedhje të substancave kimike (dezinfektues, detergjentë), prezencë e kafshëve të infektuara, etj.

Për të parandaluar këto aksidente, janë ndërmarrë masa parandaluese si: sigurimi i pajisjeve rezervë për raste emergjente (p.sh. gjeneratorë), kryerja e kontrolleve teknike periodike të pajisjeve frigoriferike, si dhe krijimi i një plani alternativ për ruajtjen e mishit, ku në rast dështimi të sistemit, mishi dërgohet menjëherë në mishtoren që pronari zotëron në qytet.

Menaxhimi i substancave kimike përfshin ruajtjen e sigurt të detergjentëve dhe dezinfektuesve, etiketimin e saktë dhe përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse për minimizimin e rreziqeve.

Po ashtu, kafshët dërgohen në thertore vetëm pasi janë kontrolluar nga inspektori përgjegjës veterinar.

Për rrjedhojë, aksidentet e mundshme që mund të ndodhin gjatë operimit të thertores vlerësohen si raste të rralla dhe me ndikim minimal, pa potencial të lartë për të rrezikuar shëndetin e njerëzve apo mjedisin, për aq kohë sa respektohen standardet e sigurisë dhe procedurat operacionale.

7. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS DHE PLANI I MENAXHIMIT MJEDISOR

7.1. Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis

Programi i monitorimit ka për qëllim të sigurojë zbatimin e masave mjedisore të përcaktuara, përmes kontrollit të rregullt nga përgjegjësit përkatës dhe në periudha të caktuara kohore, duke garantuar funksionim të qëndrueshëm dhe përputhje me legjislacionin në fuqi.

7.2. Prezantimi i gjendjes mjedisore përpara se projekti të vihet në punë ose fillimi i aktiviteteve në vendet ku ndikimi mjedisor pritet

Në rastin e thertores, kjo analizë është bërë mbi bazën e gjendjes ekzistuese, pasi objekti është ndërtuar që nga viti 2002 dhe tashmë është në funksion. Kjo do të thotë se raporti nuk trajton një fazë të ndërtimit të ri, por vlerëson ndikimet mjedisore të një veprimtarie që veçse operon, duke u fokusuar tek përmirësimi i instalimeve teknike dhe respektimi i standardeve ligjore e higjieno-sanitare.

7.3 Parametrat në bazë të të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme në mjedis

Sic u potencua më lart, në rastin e thertores, parametrat në bazë të të cilave mund të përcaktohen efektet e dëmshme vlerësohen mbi gjendjen ekzistuese pasi objekti është tashmë në funksion.

7.4. Vendet, mënyra dhe shpeshtësia e matjes së parametrave të përcaktuar

Meqenëse VNM bëhet për një objekt ekzistues, matja e parametrave nuk kryhet për të parashikuar ndikimet e ardhshme, por për të monitoruar gjendjen reale të mjedisit gjatë funksionimit të tij. Kjo nënkupton se matjet bëhen brenda objektit dhe zonës përreth, përmes marrjes së mostrave të ujit, tokës, ajrit e mbeturinave sipas metodologjisë ligjore.

7.5. Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera

Përmbajtja dhe dinamika e dorëzimit të raporteve për matjet e kryera, konsiston në dokumentimin e rezultateve të analizave të sipërmendura të cilat dorëzohen në mënyrë periodike (mujo, tremujor ose sipas kërkesës ligjore) pranë institucioneve përkatëse, duke siguruar krahasimin e vazhdueshëm me standardet mjedisore dhe garantimin e transparencës së funksionimit të objektit ekzistues.

7.6. Detyrimi për të informuar publikun për rezultatet e matjeve të kryera

Detyrimi për informimin e publikut nënkupton që rezultatet e matjeve mjedisore duhet të publikohen në mënyrë transparente dhe periodike, duke u bërë të qasshme për komunitetin lokal dhe institucionet përgjegjëse sipas ligjit për VNM. Kjo përmbledhje lidhet drejtpërdrejt me transparencën mjedisore dhe garanton informimin e publikut mbi ndikimet e thertores ekzistuese.

7.7. Programin ndërkufitar të monitorimit të ndikimit në mjedis sipas rastit

Nuk zbatohet për thertoren “Freskia”, pasi kapaciteti i saj është shumë i vogël (2–3 therje në javë) dhe aktivitetet zhvillohen vetëm brenda territorit lokal, pa gjeneruar ndikime që mund të shtrihen përtej kufijve shtetërorë.

7.8. Mbrojtja efektive mjedisore gjatë gjithë fazave të projektit

Në rastin e thertores, kjo nënkupton zbatimin e masave të kontrollit dhe monitorimit vetëm gjatë fazës së operimit dhe asaj të cmontimit, pasi objekti është tashmë i ndërtuar dhe nuk ka fazë planifikimi apo ndërtimi, duke siguruar që ndikimet mjedisore të minimizohen vazhdimisht gjatë funksionimit dhe dekomisionimit të tij.

Tabela 3: Plani për monitorimin e zbatimit të masave dhe menaxhim mjedisor

Faza e operimit					
Aspekti mjedisor	Treguesit kryesorë	Veprimet për monitorim	Koha e monitorimit	Përgjegjësia ekzekutive	Përgjegjësia monitoruese
Toka	Pastërtia e tokës, moskontaminim	Mirëmbajtje e rregullt e sistemit të trajtimit; ndarje dhe transport i mbeturinave shtazore	I vazhdueshëm	Pronari i thertores	Inspektori sanitar
Ujërat	Cilësia e ujit sipërfaqësor/nëntokësor	Mirëmbajtje e bazeneve; filtrim dhe dezinfektim i ujit para shkarkimit; monitorim periodik.	Periodik.	Pronari; Kompania e ujësjellësit	Inspektori mjedisor
Ajri	Cilësia e ajrit, erërat e pakëndshme	Ventilim natyral dhe artificial; dezinfektim i hapësirave; përforsim i strukturës kundër kushteve atmosferike.	I vazhdueshëm	Pronari	Inspektori veterinar
Biodiversiteti	Gjendja e florës/faunës përreth	Trajtim i sigurt i mbeturinave; vëzhgim i zonës përreth; trajnimi i stafit.	Vjetor & i vazhdueshëm	Pronari	Inspektori mjedisor I komunës

Mbeturinat	Sasia dhe menaxhimi i mbeturinave	Kontroll mbi grumbullimin dhe ruajtjen; transport i rregullt; krijim i zonës për mbajtje të përkohshme.	Ditor & Mujor	Pronari; Operator “Higjiena”	Inspektori mjedisor I komunës
Vendbanimi	Marrëdhëniet me komunitetin	Ruajtje e marrëdhënieve të mira me fqinjët; kufizim i aktiviteteve shqetësuese; njoftim paraprak për ndryshime.	I vazhdueshëm	Pronari	Komuna
Peizazhi	Harmonia vizuale me mjedisin	Termoizolim i objektit; fasadim me materiale lokale; mbjellje gjelbërimi.	Njëherë dhe më pas mirëmbajtje e rregullt	Pronari	Komuna
Faza e cmontimit					
Aspekti mjedisor	Treguesit kryesorë	Veprimet për monitorim	Koha e monitorimit	Përgjegjësia ekzekutive	Përgjegjësia monitoruese
Toka	Pastërtia pas çmontimit, mungesa e kontaminimit	Heqja e mbeturinave, dezinfektim i parcelës, rikthim për përdorim bujqësor	Pas përfundimit të çmontimit	Pronari i thertores	Inspektori sanitar
Ujërat	Cilësia e ujit pas mbylljes	Neutralizim i sistemit të kanalizimit, mostra laboratorike	Pas çmontimit	Pronari; Kompania e ujësjellësit	Inspektori mjedisor
Ajri	Mungesa e erërave dhe pluhurit	Pastrimi i hapësirave, ventilim gjatë çmontimit	Gjatë çmontimit	Pronari	Inspektori veterinar
Zhurma	Nivelet e zhurmës gjatë punimeve	Matje e përputhjes me ligjin akustik	Gjatë çmontimit	Kompania e punimeve	Inspektori mjedisor
Biodiversiteti	Ruajtja e gjendjes së zonës përreth	Trajtim i sigurt i mbeturinave, vëzhgim i florës/faunës	Pas çmontimit	Pronari	Komuna; Inspektori mjedisor
Mbeturinat	Menaxhimi i mbeturinave të çmontimit	Grumbullim, transport në deponi të autorizuar	Gjatë & pas çmontimit	Pronari; Operator “Higjiena”	Inspektori mjedisor
Vendbanimi	Mosshqetësi m për komunitetin	Njoftim paraprak për fqinjët, kufizim i aktiviteteve	Para & gjatë çmontimit	Pronari	Komuna
Peizazhi	Rikthimi i harmonisë vizuale	Pastrim i parcelës, gjelbërim pas mbylljes	Pas çmontimit	Pronari	Komuna

7.9. Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor

Pajtueshmëria me pëlqimin mjedisor për thertoren “Freskia” nënkupton që objekti ekzistues duhet të funksionojë duke respektuar kushtet dhe masat e përcaktuara në pëlqimin e lëshuar nga autoritetet, duke siguruar monitorim të vazhdueshëm dhe zbatim të standardeve ligjore gjatë fazës së operimit. Kjo lidhet drejtpërdrejt me respektimin e lejes mjedisore dhe garanton kontrollin institucional mbi aktivitetin e thertores ekzistuese.

8. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Ky raport është hartuar për të vlerësuar ndikimet mjedisore të Thertores “Freskia” në Voksh të Deçanit, e cila synon të përmbushë kërkesat ligjore për mbrojtjen e mjedisit dhe të marrë pëlqimin mjedisor nga autoritetet gjegjëse. Hartimi i raportit bazohet në ligje dhe akte nënligjore për

mjedisin, ndërsa metodologjia përfshin analiza në terren, intervista dhe mbledhje të dhënash për faktorë të ndryshëm mjedisorë.

Thertorja është vendosur në një zonë rurale të përshtatshme për veprimtari agro-industriale, në pronë private dhe me qasje të mirë infrastrukturore. Aktiviteti i saj është me kapacitet të vogël dhe i organizuar në një objekt të vetëm që përmban hapësira për therje, ftohje dhe administrim, me pajisje të përshtatshme higjieno-sanitare.

Janë paraqitur dy skenarë: nëse thertorja vazhdon pa leje, rrezikon pasoja ligjore, mjedisore dhe ekonomike; ndërsa me leje, ajo siguron ligjshmëri, mbrojtje të mjedisit dhe përfitime të mundshme financiare.

Aspektet mjedisore për fshatin Voksh dhe zonën ku ndodhet thertorja përfshijnë:

Gjeologjia dhe toka: Fshati Voksh ndodhet në një terren malor me toka të cekëta dhe me potencial të kufizuar bujqësor. Ato janë më të përshtatshme për pylltari, kullota dhe bujqësi të thatë me ndërhyrje agroteknike.

Erozioni: Zona është e ekspozuar ndaj erozionit, por fshati Voksh është në një zonë me erozion të ulët, me rrezik minimal për degradimin e tokës.

Hidrogeologjia dhe ujërat: Vokshi ndodhet mbi një akuifer me porozitet të çarjeve, i cili ka kapacitet të ulët ujqor. Ujërat sipërfaqësorë në zonë janë të pranishëm dhe për ujitje përdoret kryesisht Lumbardhi i Lloqanit. Nuk ka ujëra të afërt sipërfaqësorë pranë thertores, duke minimizuar rrezikun nga ndotja.

Menaxhimi i ujërave të ndotura: Fshati nuk ka rrjet kanalizimi. Thertorja përdor tri bazena për filtrimin e ujërave të ndotura, që derdhen në përrua, por kjo ndodh pas një faze paraprake të filtrimit.

Ajri dhe klima: Ajri në fshat është i pastër, me ndotje të ulët gati të papërfillshme që ndodh kryesisht gjatë dimrit për shkak të ngrohjes me dru. Trafiku është i ulët dhe ndikimi klimatik minimal.

Zhurma: Niveli i zhurmës në Voksh është i ulët. Thertorja nuk paraqet burim të konsiderueshëm të zhurmës për shkak të kapacitetit të vogël dhe organizimit të mirë të punës.

Mbeturinat: Menaxhimi i mbeturinave në komunë dhe në fshatin Voksh është i rregullt. Mbeturinat nga thertorja mbledhen menjëherë nga NPL "Higjiena" sipas marrëveshjes me pronarin.

Biodiversiteti dhe ekologjia: Fshati Voksh është pjesë e Parkut Kombëtar dhe ka biodiversitet të pasur. Megjithatë, thertorja ndodhet në zonën ndërtimore, jashtë zonave të mbrojtura, prandaj nuk ndikon negativisht në florën dhe faunën e mbrojtur të rajonit.

Popullsia dhe ekonomia: Fshati ka rreth 620 banorë, me ekonomi të bazuar kryesisht në bujqësi dhe blegtori. Migrimi ka ndikuar në strukturën ekonomike, por ka edhe investime nga mërgata.

Peizazhi dhe ndikimi vizual: Thertorja është e integruar mirë në peizazhin natyror dhe nuk shkakton ndikim vizual negativ, duke respektuar standardet mjedisore dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal.

Për vlerësimin e ndikimeve të mundshme të Thertores është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse, duke analizuar faktorët mjedisorë dhe socialë në përputhje me kërkesat e VNM. Janë shqyrtuar komponentë si toka, uji, ajri, biodiversiteti, peizazhi dhe aspektet socio-ekonomike.

Të gjeturat nga vlerësimi rezultojnë se veprimtaria e Thertores mund të ndikojë në disa faktorë mjedisorë dhe socialë, përfshirë popullsinë lokale, cilësinë e mjedisit, shëndetin publik, florën dhe faunën, peizazhin natyror dhe elemente të trashëgimisë kulturore. Po ashtu, ndikimi mund të reflektohet edhe në nivelin socio-ekonomik, veçanërisht për familjarët e përfshirë në aktivitetin e

thertores. Megjithatë, duke u bazuar në zbatimin e masave parandaluese dhe zbutëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, ndikimet e vlerësuara janë minimale dhe të menaxhueshme.

- **Ndikimi në tokë** është minimal dhe i menaxhueshëm. Sistemi i bazenëve për mbeturinat e lëngshme dhe ujërat e ndotura që dalin nga procesi i thertores funksionon. Mbeturinat e ngurta largohen menjëherë nga kompania e kontraktuar. Masat zbutëse për këtë përfshijnë zbatimin e rregullt të procedurave për grumbullim, ndarje, ruajtje dhe transportim të mbeturinave. Meqenëse objekti ka hapësirë të mjaftueshme, rekomandohet që bëhet një ri-organizim për të rregulluar edhe një hapësirë për mbajtjen e përkohshme në rast nevojë të mbeturinave të ngurta të gjeneruara nga therja. Kjo vlen sidomos në rastet kur ka festa dhe kapaciteti i thertores rritet pak më shumë se në ditët e zakonshme.
- **Ndikimi në ujëra**, poashtu është minimal, për sa kohë që baza e trajtimit të ujërave të ndotura kontrollohet. Me masat mbrojtëse si mirëmbajtje periodike, monitorim dhe trajtim para shkarkimit ky ndikim mund të kontrollohet.
- **Ndikimi në ajër** të jashtëm është i papërfillshëm për shkak të lokacionit të izoluar, kurse për ajrin e brendshëm, mungesa e ajrosjes natyrore mund të ndikojë brenda objektit, prandaj rekomandohet që të sigurohet ventilim natyror.
- **Ndikimi nga zhurma** konsiderohet të jetë i papërfillshëm për shkak të kapacitetit të ulët dhe distancës nga banesat. Nuk rekomandohet masa zbutëse përveçse monitorim dhe respektim të standardeve të përcaktuara me ligjin për zhurmë.
- **Ndikimi në biodiversitet** është i kufizuar dhe pa rrezik për llojet apo habitatet e mbrojtura. Masat përfshijnë trajtim të sigurt të mbeturinave, monitorim të rregullt dhe trajnime për personelin.
- **Ndikimi nga mbeturina:** Menaxhimi i mbeturinave sipas informatave të marra në terren është i kontrolluar dhe i mbështetur nga masa parandaluese dhe bashkëpunim institucional me ndërmarrjen Higjien, gjë që garanton mbrojtjen e mjedisit dhe funksionimin e qëndrueshëm të aktivitetit. Meqenëse ka periudha sidomos gjatë festive kur Therrtorja ka kërkesa më të mëdha për operim, rekomandohet që brenda Thertores të krijohet një hapësirë e dedikuar për mbajtjen e përkohshme të mbeturinave të ngurta të gjeneruara nga procesi i therjes.
- **Ndikimi në popullsinë dhe aspektet socio-ekonomike** është më shumë pozitiv, duke gjeneruar punësim dhe pa ndikuar negativisht në komunitet sepse edhe zona përreth, me një përjashtim, është e rrethuar me shtëpi jo-të banueshme përveçse në sezonat e pushimeve. Rekomandohet t'u kushtohet rëndësi ruajtjes së marrëdhënieve të mira me fqinjët dhe për çdo ndryshim në aktivitet, ata të informohen paraprakisht.
- **Ndikimi në peizazh dhe ndikimi visual** është vlerësuar minimal; ndërtesa është e thjeshtë dhe nuk dëmton vizualisht zonën. Por meqenëse është e pafasaduar, për të përmirësuar ndikimin vizual-estetik është rekomanduar fasadimi i saj duke ndërmarrë edhe masat për efikasitet të energjisë dhe mbjelljen e gjelbërimit dekorativ në oborrin hyrës të Thertores për të shtuar efektin mbrojtës nga ndryshimet klimatike- më konkretisht të zbutjes së efekteve nga të nxehtit ekstrem.

Thertorja mund të përballë me aksidente si: avari elektrike, defekte teknike, rrjedhje kimikatesh nga mjetet për pastrim dhe detergjentet. Por për të parandaluar efektet e tilla, janë ndërmarrë masa si gjeneratorë rezervë, kontrollë teknike, menaxhim i sigurt i kimikateve, kontroll veterinar etj, prandaj rreziku i aksidenteve vlerësohet si i ulët dhe me ndikim minimal, nëse respektohen procedurat e sigurisë. Rekomandohet që të vazhdohet me kontrollet periodike teknike dhe higjieno-sanitare,

trajnim të vazhdueshëm i stafit për reagim ndaj emergjencave dhe përdorim të duhur të kimikateve, monitorim i rregullt i sigurisë për të verifikuar zbatimin e masave parandaluese dhe vazhdim i bashkëpunimit me veterinarin për kontrollin e kafshëve para therjes.

Nga ajo që u potencua më lart, mund të konkludohet se Therrtorja subjekt i këtij vlerësimi nuk paraqet rrezik për faktorët mjedisorë dhe me ndërmarrjen e masave të rekomanduara të cilat janë lehtësisht të mundshme nga ana e pronarit, ajo plotësisht do të përmbushë kërkesat ekologjike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

9. PËRMBLEDHJA JO-TEKNIKE

Ofrohet si dokument i veçantë.

10. LITERATURA

- Plani Zhvillimor Komunal i komunës së Deçanit 2024 -2032
- Plani Hapësinor Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemura
- Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2023 – 2028
- Vlerësimi Strategjik Mjedisor i PZHK të Deçanit
- PNMIM 2025 -2035 e Rajonit të Dukagjinit
- Plani Komunal për Menaxhim të Mbeturinave Komuna e Deçanit 2018 -2022